

Rruga e Arbërit



Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. Nr. 8(16). Gusht 2007 Çmimi: 50 lekë

OPINION

Një mënyrë se si mund të gjenden financime për Rrugën e Arbërit

Nga SULEJMAN TOMÇINI
Ambasador

Ndërtimi i Rrugës së Arbërit ka qenë dhe është, si për shumë dibranë edhe për mua, një ëndërr dhe, me thënë të drejtën, aq sa kam pasur mundësi edhe kur isha në Arabinë Saudite (2001-2004), gjetjen e fondeve për të e kam pasur një nga detyrat e mia kryesore. Për këtë qëllim pata zhvilluar kontakte të ndryshme me firma dhe institucione financiare saudite.

(Faqe 4)

Një dollarë për Dibrën – Një dollarë nga Dibra

Nga BUJAR KAROSHI

"One USD for Dibra" është projekti më i fundit që vjen nga mërgimtarët nga Dibra e Madhe, të cilët duan të ndihmojnë vendlindjen e tyre të zhvillohet e integrohet. Një iniciativë e rrallë në botë, që tregon se sa e duan vendin e tyre ata që nuk jetojnë këtu, por kanë marrë me vete një nga gjerat më të shtrenjta të njeriut, dashurinë për atdheun...

(Faqe 4)

Miniera që vazhdon të vrasë

FAQE 3



REPORTAZH

Mes mrekullive dhe legjendave të Kalasë së Dodës

Nga SHAQIR SKARRA
Faqe 8,15



"Këngët e Korabit"

Një cikël i veçantë i lirikave popullore të këngëve të mërgimit, dashurisë dhe natyrës

Nga NAIM PLAKU - Faqe 10-11

DY OSTRENAS NE OMONIA

Nga ABDURAHIM ASHIKU
FAQE 8

Dibrën po e boshatis mërgimi

FAQE 3

"One USD for Dibra"

Nga LAURA PAPANIKU
FAQE 6

Atli Dema: Ja projektet tona për ruajtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor në Dibër

Nga VALBONA ZUNÇE
FAQE 7

Emërtimet duhet të jenë shqip

Nga REXHEP TORTE
FAQE 8

Urbanizmi më shumë preferon fushën se sa kodrat

FAQE 6

Dibra e Madhe bëhet me galeri të arteve

FAQE 6

23 gushti 1944 – Çlirimi i Dibrës

Çlirimi i Dibrës nga pushtuesi nazist u besua Divizionit të Parë të porsakrijuar me komandant strategun Dali Ndreu. Divizioni kaloi Shkumbinin që të ndihmonte forcat partizane të Dibrës, për çlirimin e krahinave. Brigadat e Divizionit, në bashkëpunim të ngushtë me komandantin partizan të Dibrës, Haxhi Lleshin, të batalionit të Çermenikës, Martaneshit e të Matit, të përkrahur nga populli lridashës, çliruan zonat në lindje të Tiranës, Zaranikën, Çermenikën, Gollobordën, Zerqanin e Matin. Ndërsa Homeshi dhe Peshkopia u çlirua nga partizanët e Dibrës.

Komanda gjermane e kuptoi rrezikun. Partizanët po vinin nën kontroll rrugët strategjike të lëvizjes dhe të tërheqjes. Prandaj organizoi operacionin luftarak kundër Divizionit të Parë dhe forcave partizane lokale. Ky operacion i quajtur "Syri i Skifterit". Përbëhej nga 8000 forca dhe filluan mësymjen me tri kolona me luftime të ashpra. Në këto beteja ranë dëshmorë nga Batalioni i Dibrës në Fushë-Alie: Demir Gashi, Riza Doda, Stefan Luarasi, Hasan Braha etj. Nga Divizioni i Parë: Myslim Shyri, Zonja Çurre,

Nimete Progonati, Ropi Gostivishiti, Muharrem Kardali, Xhuzepe Pinjateli, Thanas Burnazi etj.

Në dy javët e dyta të korrikut gjermanët dhe një e pjesë parisë së Dibrës, vunë nën kontroll gjithë krahinat që patën çliruar forcat partizane. Brigada e IV u përqëndrua në Kaptinë të Martaneshit, Brigada e V luftonte në Mat, Brigada e I dhe batalioni i Dibrës, pas luftimeve në Fushë-Alie, kaluan Korabin në Qafë të Valivarit dhe vazhduan luftën në Rekë e Kararman.

Brigada e IV në natën e 24 korrikut sulmoi në bashkëveprim me forcat vullnetare të Grykës dhe fituan mbi batalionin e xhandarëve. Zerqani u çlirua përfundimisht. Në këtë ndeshje dhanë jetën partizanët: Niko Ligori dhe Nazmi Durmishi.

Brigada marshoi natën e 25 korrikut për Luzni. Kaloi Drinin për të çliruar fshatrat. Më 28 korrik ishin në Fushë-Alie. Njëherësh Brigada e V lëvizti nga mali i Allamanit në drejtim të Selishtës, malit të Lukanit dhe doli në Sinë dhe në Grykë të Nokës. Kundërshtari u fut në darë rrethimi.

Më 29 korrik 1944 dy brigadat e Divizionit të parë sulmuan Peshkopinë, ku ishin mbledhur gjithë forcat kundërshtare, të cilat qëndruan të vendosur mban një beteje të rreptë e të rrefeshme. Por forcat partizane e çliruan qytetin. Forcat partizane kundërsulmuan dhe i ndjekin deri në afërsi të Dibrës së Madhe.

Në këtë përpjekje u vra Riza Kryemadhi dhe Shahin Merdini. Betejat në Hynoskë e Skërtec më 22 gusht dhe në Dibër të Madhe qenë të fundit përlëshje të partizanëve me nazistët gjermanë.

Në të gjitha veprimet luftarake të Divizionit të Parë në Dibër morën pjesë repartet partizane të Batalionit të Dibrës, çetat vullnetare të Zerqanit, të Aqif Lleshit, Faik Shehut e Beshir Sufës.

Pushtuesit nazistë u larguan të vrarë të plagosur. Dibra u çlirua duke dhënë jetën shumë dibranë në të dy krahët kundërshtarë.

Lutfi Hanku



Ura e Muhurrit... ashtu siç nuk duhej të ishte...

Ura e Skavicës mban peng rrugën Peshkopi - Kukës

Janë me qindra udhëtarë që udhëtojnë në rrugën Peshkopi -Kukës ose anasjelltas. Ka ditë që këto udhëtar ndërmarrin aventura të ndryshme për mungesë të rrugës së tyre. Këto ndjekin rrugë të panjohura më parë për ta vajtur në destinacion pasi është pikërisht ura e Skavicës e cila nuk ua krijon këtë mundësi udhëtarëve. Ajo është e prishur dhe ende nuk është marrë asnjë masë për meremetimin e saj. Rruga bashkë me urën janë ndërtuar në vitet 1945-1946 dhe është një ndër veprat e para në shkallë vendi. Atëherë u quajt rruga e Rinisë pasi në hapjen e kësaj traseje të vështirë punuan mijra të rinj dhe të reja. Kjo rrugë deri vonë ka qenë e vetmja që bashkonte Peshkopinë me Kukësin si dhe anasjelltas. Nëpër këtë rrugë përmes makinave të ndryshme kishte dhe autobus për udhëtarët. Për mirëmbajtjen e kësaj rruge janë shpenzuar nga buxheti i shtetit qindra milion lek për mirëmbajtjen e saj dhe megjithatë deri tani e vetmja rrugë që nuk ka njohur rehabilitime serioze. Ura e Skavicës e cila bashkon Peshkopinë me Kukësin sot është e prishur dhe makinat nuk mund të futen në të. Megjithatë ura ka bazament hekuri kalimi i automjeteve mbi të është tepër i vështirë dhe me rrezik. Po thuaj e gjithë dysheja e dërrasave ka rënë në lumin Drin nga dëmtimi i erozionit si dhe vjetërsia. Banorët tregojnë se jo vetëm mjetet por kalimi në këtë urë është i vështirë dhe për këmbësorët. Drejtues të komunës në Ujmisht thonë se ura nuk është në in-

ventarin e tyre por të entit të rrugëve. Këta të fundit e pranojnë si fakt gjendjen e mjeruar që ndodhet jo vetëm ura por dhe e gjithë traseja e rrugës thanë se për meremetimin e kësaj ure do të duheshin jo më pak se 400 mijë lekë. Deri tani nuk është bërë asgjë as për urën dhe as për trasenë e rrugës prej 84 kilometrash.

Pasojat e emërtimeve sllave në Dibër

Dibër e Madhe e Dibër e Vogël, dhe jo Peshkopi

Shpeshherë kemi rastin që nga mediat në Shqipëri për ngjarje të lidhura me Dibërën e Vogël-Peshkopinë, dëgjojmë ta përdorin shprehjen "Në Dibër ka ndodhur kjo e kjo". Një gjë e tillë për opinionin në Shqipëri është e qartë dhe e kuptueshme, pasi ata e kanë të qartë dhe e kuptojnë se bëhet fjalë për Dibërën e Vogël-Peshkopinë, që ndodhet në Shqipëri, ndërsa për opinionin në Dibër të Madhe që ndodhet në Maqedoni dhe për tërë shqiptarët në Maqedoni, kjo shkakton hamendje, sepse nuk e dijnë a është fjala për ngjarje në Dibërën këtej, apo matanë kufirit.

Për popullin e këtyre anëve me shekuj kanë ekzistuar vetëm emërtimet Dibër e Madhe dhe Dibër e Vogël.

Nëntë malet e Dibrës që ishin Reçi, Dardha, Qidhna, Muhuri e Luznia në Dibër të Vogël dhe Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza e Katër Grykët në Dibër të Madhe që ishin Selishtja, Qafa e Murës, Lukani e Kacnia, qysh në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitet 1912/13 dhe të konfirmuara edhe në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1020/21, mbetën me shtetin amë Shqipërinë, ndërsa Dibra e Madhe iu dhurua Serbisë së Madhe e më pastaj Maqedonisë.

Mësymjet okupuese serbe kanë bërë që Dibërën e Vogël për shkak të ndonjë peshkopate të vendosur atje forcërisht, ta pagëzojnë edhe Peshkopi. Kështu që Dibërën së Vogël dashtë pa dashtë i është ngjitur edhe bishti surogat i emërimit Peshkopi.

Pjesa dërmuese e popullatës në Shqipëri në bisedat e përditshme, sa herë që bëhet fjalë për Peshkopinë përdorin shprehjet Dibër dhe dibran, e ç'është edhe më interesante e bindëse edhe targat e automjeteve në Rrethin e Dibrës

Letër në redaksi

Me vjen shumë mirë që ka intelektualë si ju, grupi nismëtar, me përkrahjen maksimale nga mbarë populli jonë, që ky projekt i ëndërruar në vite i Rugës së Arbërit, të realizohet në mënyrë sa më të shpejtë, që edhe ne, të emigruarit nëpër shtetet e huaja, më në fund të mendojmë kthimin në vendlindjet tona.

Flas ne emrin tim personal, që si një mërgimtar që nga gjendja ekonomike e mbarë zonës të Dibrës nuk më jep mundësinë që të jetoj e të punoj në vendlindjen time të bukur.

Mbas pesëmbëdhjetë vjet mërgim vizitova vendlindjen dhe duke biseduar me shume bashkëqytetarë në lidhje me Rugën e Arbërit, shumica e të cilëve nuk e lëshojnë tokën mëmë, janë shumë optimistë, që si zgjedhje e vetme për të ndaluar egzodin Dibran, është realizimi i këtij projekti.

JU PERSHENDES
YMER DEDJA
NAPLES FL. SHBA



dëshmojnë qartë se në popull më shumë është i preferueshëm dhe sundon përdorimi Dibër se sa Peshkopi.

Po t'i shfletojmë edhe marrëveshjet dhe protokollet ndërshtetërore mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, Pala shqiptare zakonisht e përdor termin Dibër dhe asnjëherë Peshkopi. Kjo bën që në dokumentet e marrëveshjeve në shtetërore në gjuhën shqipe dhe në dokumentet e marrëveshjeve ndërshtetërore të përkëthyer edhe nga maqedonishtja të del vetëm nocioni Dibër.

Të gjendur para një situatë të këtillë, do të ishte mirë që të respektohet dhe zyrtarizohet përdorimi i emërimit Dibra e Madhe, me çka do të nënkuptohej Dibra në Maqedoni, dhe Dibra e Vogël, me çka do të nënkuptohej Dibra në Shqipëri, gjë që është shumë e qartë dhe e kuptueshme për tërë opinionin e kësaj zone në dy anët e kufirit. Me këtë do t'i jepej fund edhe përdorimit të nocionit Peshkopi, si padrejtësi e imponuar historike dhe si surogat nga e kaluara ku dominonin okupimet serbe të trojeve shqiptare.

Rexhep TORTE

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: RAKIP SULI. Kryeredaktor: SHAQIR SKARRA.
Redaksia: Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani, Bujar Karoshi, Rexhep Torte, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala,
ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", market "KEN", Laprakë.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. E-mail: lid_gazeta@yahoo.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë dhe Shoqatës "LID".

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë",
PROCREDIT BANK. Nr. Llog: Në lek 13-661344-0001.
Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203.



Miniera e Bulqizës vret përsëri

Nga SHAQIR SKARRA

Më datë 28 gusht u vra dhe një minator në minierën e Bulqizës. Mehdi Jani mbeti poshtë zgafellave të nëntokës duke lënë jetim pesë fëmijë. Para pak kohësh u vra dhe minatori Zaim Hysa dhe e gjitha kjo erdhi si pasojë e kushteve të këqija të punës. Zaim Hysa ishte dhe një ndër organizatorët e protestave që u zhvilluan dit më parë. Tashmë as Mehdi Jani, as Zaim Hysam as ato dy minatorët që u vranë tre muaj më parë nuk jetojnë më. Katër vdekje në tre muaj përpun Bulqiza e cila tashmë është kthyer në një skëterrë të vërtetë, në një kulçedër, në një lubi që rrëmben përherë jetë njerzish, që paralamëron për vdekje të tjera. Miniera e kromit Bulqizë është themeluar 60 vjet më parë. Nëqoftëse arkivi i kësaj miniere do të kishte statistika të sakta numri i atyre që kanë mbetur nëpër galeritë e saj do të ishte marramendësh. Ende nuk dihet se pse rri hapur kjo minierë përdërisa kjo nuk siguron ndonjë mirëqenje për ato njerëz që ende shpresat i kanë lidhur me të, por vetëm përcjell kumtet e një pas njëshme të vdekjeve të tyre nëpër puse dhe galeri të lagështa e të pasigurta. Vetë minatorët dhe sindikatat u shprehën se vdekja aksidentale e Mehdi Janit dhe Zaim Hysës erdhi si shkak e kushteve të vështira të punës të cilat këtu në Bulqizë janë tepër të vështira. . . Pas viteve nëntëdhjetë shteti ia ktheu shpinën minierës më të madhe të kromit në vend. Privatizimi i saj nuk sollti ndonjë dobi as për vendin, as për qytetin e vogël struktur me sasive dhe as për vetë minatorët. Është akoma ajo minierë që ka ekzistuar vite më parë. Privati e mori sa për të shfrytëzuar rezervat e kromit. Po investimet? Deri tani nuk është bërë asgjë. Janë po ato galeri me shtylla druri vende vende të kalburat, janë kushtet e punës më të këqija se vite më parë kur punonin minatorët, jepet një pagë qesharake. Shpresuan të gjithë në fillim kur minierën më të madhe në vend e mori firma "Darfo Albania" por zhgënjimi që i menjëhershëm. Shfrytëzimi i kromit filloi si më parë. Minatorët filluan punë po në ato kushte pune e paga qesharake. Ishin të detyruar të gjithë t'u ktheheshin galerive se nuk kishin asnjë mundësi

tjetër për punë. Këtu mund të siguronin jetesën për familjet e tyre. Dhe kompania "Darfo Albania" e dinte kaq gjë se vetë qyteti i Bulqizës ishte i lidhur ngushtë me galeritë nëntokësore por qëllimi i saj final ishte që të shfrytëzonte sa më shumë mineralin e çmuar të kromit. Minierën e Bulqizës sot e administron kompania ruso-austriake "Deko-Metal" (dhe kuptohet qartë se çfarë administrimi bën kjo kompani kur qytetin e Bulqizës e ka mbuluar vdekja) por është një qeveri shqiptare që administron vendin e vet (dhe kur aty punojnë sipërmarrje të huaja) dhe që kanë për detyrë të kujdeset jo vetëm për fatin e pasurive nëntokësore, nëse ato vërtet sjellin pasurimin (apo varfërimin e shqiptarëve) por mbi të gjitha për jetën e njeriut, njerëzve të nëntokës që hyjnë çdo ditë në zgafellat pa dritë dhe ajër të saj ngaqë nuk kanë asnjë mundësi tjetër jetese. Është kjo arsya që minatorët e Bulqizës i drejtuan qeverisë për t'i shpëtuar nga "shfrytëzimi" për t'u gjendur pranë tyre, që i ftuan pushtetarët të venin njëherë atje tek kromi por që ato nuk vajtën dhe vetëm pastaj ato njerëz të lodhur marshuan drejt Tiranës. Ato në fakt e dinin se miniera nuk ishte më e preferuara e shtetit, nuk siguronte të ardhura për buxhetin e tij, se shteti kështu kishte kohë që e kishte braktisur minierën e Bulqizës dhe të gjithë minierat e vendit. Por sidoqoftë ato e donin mbështetjen e qeverisë për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e pagës e cila ishte vërtet qesharake. E njëra nga ato zëra protestues pranë qeverisë ato ditë në metropolin shqiptar ishte dhe zëri i Zaim Hysës. - Mos e paçi fatin të futeni në ato galeri, thoshte Zaim Hysa. E minator Zaim Hysa sikur e kishte ndjerë se vdekja do t'i vinte pikërisht nga galeritë e nëndheshme të minierës. Vdekjen e tij nuk e ndali as mortja e dy shokëve të tij dy muaj më parë, kur qyteti minator u vesh në të zi, as protestat e minatorëve përpara kryeministrit për paga më të larta dhe kushte të mira pune. Vdekjen e Mehdi Janit dhe Zaim Hysës nuk e ndalën as masat ekstreme që u morën ndaj dy inxhinierëve të minierës. Nuk e ndalën as ato që quhen sindikata apo konfederata. Vdekja në këtë qytet të vogël nuk mund të ndalet, ajo nuk mund

të ndalet nën tokë nën hijen e rëndë të malit të Duriçit. . . Tragjedi nëntokësore ndodhin kudo nëpër botë, ato nuk kursejnë as dhe Amerikën, por atje krejt ndryshe është interesimi për jetën e njeriut, atje jeta e tjetrit vlen shumë. Kompania "Deko Metal" u ul një ditë në qytetin e Bulqizës, u ul jo për të investuar por për të administruar minierën më të vjetër në vend, për të shfrytëzuar mineralin e kromit megjithëse në kontratën e marrëveshjes kusht kryesor ka investimin në minierë. Deri tani nuk ka derdhur qoftë dhe një qindarkë në investim. . . Minatorët u ngritën në protesta, u futën dhe në grevë urie. U kërkua dhe dorëheqja e ministrit por zëri i tyre shpejt u shua. Minatorëve ju premtua vetëm 30% shtesë rroge dhe asgjë tjetër. Kjo u bë vetëm se sa të shuheshin protestat dhe minatorët t'i ktheheshin punës përsëri. Bulqizakët kanë një jetë me minierën e kromit, një jetë kanë kaluar nën tokë. Sot një realitet tepër i zyrtë. Jo Bulqiza por e gjithë Shqipëria ishte zhvilluar falë kromit që fsheh nëntoka.

Faktet janë kryeneçe. Mjerimi në këtë qytet të vogël minator është ulur shtruar në të gjitha familjet. Nuk ka asnjë mënyrë se si mund të sigurojnë të ardhurat për jetesë. E vetmja shpresë është miniera dhe kjo vazhdon të jetë e viteve më parë. Prej kaq vitesh nuk po bëhen asnjë lloj investimi. Të futesh sot nëpër galeritë e Bulqizës të zë tmerri e jo më të gërmosh. Bulqiza përherë e më shpesh po kthehet në një kulçedër, në një lubi që rrëmben jetë njerëzish. Pas vdekjes aksidentale të minatorit Zaim Hysa minatorët e Bulqizës iu kthyen përsëri protestave. Është e vetmja rrugë që mund të bëhet sado pak për të përmirësuar kushtet e punës. Kolë Nikolli kryetari i konfederatës së sindikatave u shpreh se deri tani nuk është investuar asgjë në minierë, nuk është vënë as dhe një dru ahu nëpër galeritë e saj. E minatorët të mbështetur edhe nga sindikatat dhe i gjithë qyteti i Bulqizës iu kthyen përsëri protestave. Ato që nga dita që përcollën mbi supë arkivolin me trupin e pa jetë të shokut të tyre Zaim Hysës e kanë ndërprerë punën. U desh dhe një vrasje tjetër që Ministria e Ekonomisë të vendoste mbylljen e minierës deri sa të plotësohen kushtet e punës. Megjithatë, miniera e Bulqizës vazhdon të vrasë përsëri. . .

Dibrën po e boshatis mërgimi

Tepër shqetësues është lajmi që mora këtyre ditëve, që tre studentë dibranë kanë vendosur t'i lanë studimet dhe të emigrojnë në SHBA. Kjo për asgjë tjetër, veçse nga shkak se i shohin bashkëvendësit e tyre që sa vite të diplomuar nuk kanë asnjë ditë stazh pune, nuk kanë mundësi të punësohen, të fitojnë e të krijojnë familje. Dëshirën për të emigruar ata kanë vendosur ta realizojnë fillimisht nëpërmjet kërkesës së vizës amerikane, por nëse nuk arrijnë në këtë mënyrë të rregullt, ata kanë vendosur të hyjnë borxh e të paguajnë edhe nga 20 mijë dollarë për të emigruar nëpërmjet kanaleve ilegale.

Fenomeni i emigrimit tashmë është bërë përditshmëri e këtij qyteti të lashtë me një histori sa të lavdishme aqë edhe të dhembshme.

Nuk ka javë që nga Dibra të mos emigrojë dikush. Refreni më i dëgjuar në qytet është kërkesa e mundësisë për tu larguar në ndonjë shtet të huaj, por më shumë në SHBA.

Çdo fillimvit shkollor është bërë dukuri që mësuesi të mos e përmend më emrin e nxënësit apo nxënëses, pasi kanë mërguar. Të shpeshta janë ditët kur filan qytetari më nuk shihet të shëtisë rrugëve të qytetit, sepse merret vesh që ka mërguar. Të shpeshta janë ditët kur numrit të shtëpive në Dibër ku nuk banon asnjë njeri, i shtohen shtëpi tjera të mbyllura me çels, pasi familje të tëra kanë mërguar.

Jeta në Dibër është bërë e vështirë. Punë dhe vende punë nuk ka, ndaj edhe prindërit edhe rinia dibrane ndjehen tejet pesimistë me që në vendlindje nuk shohin asfarë perspektive. Të rinjtë dibranë me diploma universitare janë të detyruar të sorollaten rrugëve dhe kafeneve të qytetit, me përjashtim të ndonjë aktiviteti të rallë kulturor apo sportiv.

Në bisedat që zhvillohen në odat dibrane, dëgjohej të flitet se papunësia e madhe, mungesa e fondëve dhe e projekteve të miratuara për zhvillimin e ekonomisë së vogël dhe fenomeni i pasigurisë, i detyrojnë të kapin rrugën pakthim të mërgimit.

Rrugët e Dibrës tashmë më shumë se pemëbëdhjetë vite nuk dëgjohej të gumëzhijnë nga njerëzit që shkojnë në punë orëve të mëngjez, e që këthehen nga puna orëve të pasditës. Në çdo kohë të ditës nëpër rrugët e qytetit takon shumë pak njerëz.

Ky është treguesi më shqetësues se Dibra po boshatiset pamëshirshëm, e me këtë realizohen edhe planet ogurzeza sllave për ta zbehur Dibërën dhe për ta shuar fare.

Një mik këtyre ditëve më tregoi se në SHBA restorantet për dibranët janë bërë të ngushta, sepse ndodh që zotit të dasmës i duhet të thërrasë edhe më shumë se një mijë dasmorë dibranë. Kjo është edhe një dëshmi se në SHBA ka vajtur të jetojë gati një Dibër e tërë.

Fjalët e bukura e premtuese që dëgjojmë në metingjet parazgjedhore, dibranët do të dëshironin t'i shohin në vepra konkrete. Edhe një vend i hapur pune në Dibër don të thotë frenim i mërgimit, frenim i boshatisjes dhe i turrjes së Dibrës.

Rexhep TORTE

Një dollarë për Dibrën – Një dollarë nga Dibra

Nga BUJAR KAROSHI

“One USD for Dibra” është projekti më i fundit që vjen nga mërgimtarët nga Dibra e Madhe, të cilët duan të ndihmojnë vendlindjen e tyre të zhvillohet e integrohet. Një iniciativë e rrallë në botë, që tregon se sa e duan vendin e tyre ata që nuk jetojnë këtu, por kanë marrë me vete një nga gjerat më të shtrenjta të njeriut, dashurinë për atdheun. Kjo iniciativë mund të çojë shumë shpejt që dibranët të mbledhin për vendlindjen e tyre rreth njëqind mijë dollarë në vit e ndoshta më shumë, që e përkthyer në investime do të thotë një shkollë më shumë, një rrugë lagjeje

bërë. Punëtorët e firmës që kishte fituar tenderin për ndërtimin punonin ditën, hapnin kanale e shtronin tuba dhe natën shkonin e i vidhnin tubat. Në mëngjes, sikur nuk dinin gjë, shkonin dhe shihnin se tubat ishin vjedhur. Por nuk u bënte përshtypje ky fakt. Ata vazhdonin të hapnin kanale e të shtronin tuba. Kur fshatarët u ankuan se kështu nuk po ndërtohej ujësjellësi, ata thoshin: *S'kemi faj ne, vetë i keni vjedhur tubat. Ne paguhemi për t'i shtruar njëherë, jo sa herë i vidhni ju, ne t'i shtrajmë.* Kështu ujësjellësi u ndërtua me “një paketë tubash” dhe fshatarët, përveç një kanali që hapej e mbyllej, ujë nuk panë në shtëpi. Dhe, natyrisht, kjo nuk është për të



Makina pa targa
që transportojnë
lëndë drusore

më shumë, një lulishte më shumë e kështu me radhë. Investimi i këtyre dibranëve atdhetarë për vendlindjen e tyre do ta çojë Dibrën e Madhe pas disa vitesh të mos ndryshojë shumë nga vendet ku ata punojnë, përsa i përket infrastrukturës dhe mjediseve publike.

Kjo përpjekje për të ndihmuar vendlindjen do të ketë edhe një ndikim tjetër pozitiv: do t'i bëjë drejtuesit lokal në Dibër të jenë më të ndërgjegjshëm për punën e tyre, duke mos lënë asnjë dollarë të shkojë dëm, pasi kështu do të çonin dëm një dollarë të vëllait të tyre emigrant, shokut, mikut, njeriut të tyre të dashur që jeton e punon larg, por një pjesë të zemrës e kanë të lidhur më vendlindjen.

Por, ndërsa vëllezërit tanë matanë kufirit mendojnë për zhvillimin, ne në këtë anë duket se mendojmë ndryshe. Jo që nuk mendojmë të mbledhim 1 dollarë në muaj për vendlindjen, por edhe iniciativave që burojnë për zhvillimin e Dibrës u vihen “gurë nën rrota”, për të dëshmuar se *dibranët nuk janë bashkëpunues e largpamës për vendlindjen e tyre, nuk janë për t'i dhënë Dibrës 1 dollarë në muaj, për sa kohë ata nuk janë vetë ideatorët dhe organizatorët e projektit.*

Javën e parë të gushtit m'u desh të shoqëroja një nga dibranët e matanë kufirit për në Lurë. Kishte planifikuar qysh para një viti të shkonte në Lurë e natyrës së mrekullueshme, liqenëve fantastikë e njerëzve të mrekullueshëm, për t'i xhiruar e për të bërë fotografi. Pastaj ato bukuri natyrore dhe atë mikpritje fantastike do t'ia bënte të ditur nëpërmjet internetit, falas, mijëra shqiptarëve e miliona të huajve anekënd botës, duke i ftuar ata të vizitonin Lurën, këtë dhuratë fantastike të Zotit për Dibrën. E kështu, dollarë pas dollari do të rriteshin në Dibër të ardhurat, duke e sjellë zhvillimin. Por, shoferi i furgonit na la në mes të rrugës, pasi mori vesh se njëri nga ne të katër “të marrosurit” vinte nga Amerika dhe për 1(0) dollarë më shumë nuk mund të na çonte në Lurë, pasi rruga ishte e prishur. Për 1(00) dollarë më shumë sot, ishin vënë edhe zjarret në Lurë. Njërit mal i ishte vënë flaka, pasi kështu trafikantët e drurit do ta kishin më kollaj shfrytëzimin e pyllit, malit tjetër i ishte vënë flaka për inat të Habes, pasi kishte hequr dikë nga puna dhe tjetrit mal për inat të të zotit që e kishte privatizuar pa të drejtë.

Këto e shumë dokrra për 1 dollarë na i tregonte një djalë i ri nga Lura, që na kapi rrugës e na ndihmoi me kalin e tij të bardhë të mbante çantat pa na kërkuar një dollarë, ndërsa furgoni u kthye pa 1 dollarëshin për të zotin.

Por historia me zjarrvënien më kujtoi edhe një histori tjetër të dëgjuar në Peshkopë për ndërtimin e një ujësjellësi në një fshat të Di-

bituar 1 dollarë, por një të tillë me shumë zero pas. Tamam si në përralla: Ishin tre vetë që do të mbillnin pemë anës rrugës së fshatit; i pari hapte gropën, i dyti mbyllte pemën, i treti mbyllte gropën. I dyti u sëmur, por puna nuk u ndërpre, i pari hapte gropën, i treti mbyllte gropën. Pemë nuk shiheshin gjëkund...

Kur po fotografoja ca pisha në Peshkopë, njëra prej tyre pashë që ishte e djegur. M'u afrua një burrë rreth të pesëdhjetave dhe më tha: *Mos fotografo or djalë, se nesër a pasnesër nuk do të jenë këto pisha!* Aty ka mundësi do ndërtohet një kafene a bilardo, natyrisht për 1 dollarë më shumë në ditë për të zotin që e ka blerë dhe 1 dollarë më pak për Peshkopinë... Për 1(00) dollarë më shumë çdo ditë e më shumë Peshkopisë po i ikën bukuria, duke ndërtuar pa kritere urbanistike e plane zhvillimi.

Një rast tjetër shumë i freskët për mënyrën se si i merret 1 dollarë Dibrës është edhe miniera e Bulqizës. Nga dy kërkesat kryesore të minatorëve, njëra është rritja e investimeve që pronarët i kanë premtuar gjithmonë, por asnjëherë nuk i kanë bërë. Nuk kanë bërë investime strategjike për shfrytëzimin maksimal të minierës, as investime në rritjen e sigurisë së jetës. Kështu, pronarët mendojnë maksimalisht mbledhjen e kromit, pavarësisht nga mënyrat, për të fituar 1 dollarë më shumë. Nuk ka rëndësi nëse mbetjet e kromit mbulojnë edhe qytetin...

A ka shembuj të tjerë në Dibër që tregon se për 1 dollarë më shumë në xhepat e investitorëve e tenderfituesve kanë mbetur projekte pa përfunduar? Natyrisht që po: ujësjellësi i Sopanikës, ujësjellësi i Peshkopisë, meremetimet në rrugën aktuale nacionale, unaza e qytetit, pallati i sportit, rrugët e brendshme në Kamen, e shumë e shumë investime të tjera të nisura e të papërfunduara.

Të gjitha këto, sepse nga projektet në realizim kanë humbur dollarët rrugës dhe kështu mbeten projektet të pa përfunduara dhe Dibra mbetet e pazhvilluar.

Mjafton një rast shumë domethënës: Për të shkuar në llixha, te kjo pasuri me të cilën krenohemi, rruga rreth 2 kilometra ka mbetur në gjysmë e përfunduar... për mungesë fondesh. Sikur komuniteti që fiton të ardhura nga llixhat të kishte dhënë 1 dollarë taksë për çdo klient për muajt e shfrytëzimit të llixhave, rruga në llixha do të ishte e rregulluar, por jo vetëm me asfalt, por edhe me trotuar, pemë e lule, që do të kishte dëshirë të bëje me këmbë.

Por kjo nuk ndodh dhe nuk ka për të ndodhur, për sa kohë në kokën tonë në vend të mendojmë “Një dollarë për Dibrën”, zbatojmë parimin “Një dollarë (zhvatur) nga Dibra”.

Një mënyrë se si mund të gjenden financime për Rrugën e Arbërit

Ja çfarë do t'i kërkoja z. Besnik Mustafaj dhe z. Lulzim Basha!

Nga SULEJMAN TOMÇINI
Ambasador

Ndërtimi i Rrugës së Arbërit ka qenë dhe është, si për shumë dibranë edhe për mua, një ëndërr dhe, me thënë të drejtën, aq sa kam pasur mundësi edhe kur isha në Arabinë Saudite (2001-2004), gjetjen e fondeve për të e kam pasur një nga detyrat e mia kryesore. Për këtë qëllim pata zhvilluar kontakte të ndryshme me firma dhe institucione financiare saudite. Si më i përshtatshëm për një gjë të tillë më është dukur Fondi Saudit i Zhvillimit, i cili jep kredi shumë të buta dhe për periudha relativisht të gjata kohore. Që nga krijimi i tij, ai kishte dhënë rreth 75 miliardë dollarë kredi për shtete të ndryshme të botës. Për kuriozitet mund të them se nga ky fond kishte marrë kredi edhe qeveria kineze. Kusht për dhënie e kredive nga Fondi Saudit i Zhvillimit është që marrëveshja të bëhet me qeveritë dhe jo me shoqata apo firma private. Po ashtu ai kërkon që, para se të japë kredinë, të ketë në dorë projektin, të cilin e studiojnë specialistët e tij, që, nga ana e vet, ia kalojnë për aprovim bordit drejtues të Fondit, ku përfaqësohej edhe Ministria e Jashtme Saudite.

Me thënë të drejtën, sa herë që kam biseduar me drejtuesit e këtij fondi, gjithnjë janë treguar shumë dashamirës, duke thënë se ishin gati t'i jepnin Shqipërisë kredi deri më 3% dhe për një periudhë 20-vjeçare, por vetëm t'u dërgoheshin projektet që dëshironim për kreditim. Por gjithnjë problemi ngectë në Tiranë. Sa herë që dilja me ndonjë propozim për mundësinë e kreditimit nga Fondi Saudit i Zhvillimit, përgjigja nga MPJ jonë, e cila drejtohej nga ministra socialistë, ishte se nuk disponoheshin projekte. Kështu që, sa kohë punova në Arabinë Saudite, nuk mund të bëja asgjë në këtë drejtim.

Pasi u ktheva në atdhe, sidomos pas ardhjes në qeverisje të demokratëve, bëra çmos të takoja ish-ministrin e Jashtëm, z. Besnik Mustafaj, me shpresë ndoshta qeveritarët e rinj do mund të bënin ndonjë veprim për sigurimin e fondeve për ndërtimin e Rrugës së Arbërit. Shkova dy herë në Ministrinë e Jashtëm, por nuk munda ta takoja dot.

Në këto kushte mendova

të takoja ministrin e Komunikacioneve, z. Lulzim Basha, i cili është edhe dibran. Dhe rasti m'u dha në mars të këtij viti, ndërsa po shoqëroja ambasadorin e Kuvajtit me rezidencë të përhershme në Bullgari, që erdhi për paraqitjen e letrave kredenciale. Për fatin tim, ambasadorin e pritë edhe z. Lulzim Basha, me të cilin trajtuan marrëdhëniet dypalëshe.

Pasi mbaroi takimi ministër-ambasador, unë u vonova me qëllim dhe iu prezantova z. Basha, duke i thënë: - Jam Sulejman Tomçini, nga fshati Pollozhan i Peshkopisë. Kam qenë ambasador në Arabinë Saudite. Pastaj si me shaka, i thashë se fis me mbiemër Basha ka pasur vetëm në Pollozhan dhe se edhe Bashat Shimçanit janë të shpërngulur nga Pollozhani. Dua të bisedoj me Ju për një problem...

Ende pa mbaruar unë fjalinë, më ndërpreu:

- E ke fjalën për Rrugën e Arbërit?

- Po, - i thashë unë.

Më tha se do të më telefononte dhe të bisedonim. Por, gjithë këto muaj dhe unë nuk munda ta takoj më ministrin, i cili, edhe tani në Ministrinë e Jashtëm, mundet të japë kontributin e tij direkt për ndërtimin e Rrugës së Arbërit.

Tani të kthehem tek titulli i këtij shkrimi: Çfarë do t'i thoja z. Besnik Mustafaj dhe z. Lulzim Basha!

Do t'i flisja për mundësinë që ekziston për kreditimin e ndërtimit të Rrugës së Arbërit nga Fondi Saudit i Zhvillimit, natyrisht duke përgatitur më parë projektin e saj, që, me sa jam në dijeni, mund të kushtojë rreth 3 milionë dollarë. Mendoj se kjo shumë nuk është e pamundur për Qeverinë dhe ajo duhet ta japë sa më parë, nëse me të vërtetë është për ndërtimin e kësaj rruge. Mbase të jetë bërë gati projekti, t'i dorëzohet ai Fondit Saudit të Zhvillimit. Kjo mund të bëhet nëpërmjet ambasadës tonë në Riad, ose duke dërguar që këtu një delegacion qeveritar, i cili të nënshkruajë edhe marrëveshjen përkatëse, nëse do arrihej.

Si përfundim, mendoj se ia vlen barra qiranë të bëhet një sondazh i ri pranë Fondit Saudit të Zhvillimit qoftë për Rrugën e Arbërit, qoftë për ndonjë projekt tjetër prioritar për Qeverinë dhe vendin. Unë, nëse do duhej ndihma ime, jam gati ta jap.

Mes mrekullive dhe legjendave të Kalasë së Dodës

Nga SHAQIR SKARRA

Këtë mëngjez të freskët Gushti udhëtojmë drejt Kalasë së Dodës. Pasi bëmë mbi katër orë udhë e lamë pas qytetin e bukur të Peshkopisë dhe makina tashmë fillon e rrëshqet ngadalë në rrugën e pashtruar e gjithë gropa. E dimim këtë rrugë qysh kur u nisëm nga Tirana ndaj dhe ne morëm një makinë tip fuoristradë që vetëm kjo lloj makine mund ta përballonte këtë rrugë. Nuk ishte hera e parë që shkellim në këtë trevë të njohur por sa herë që shkonim na dukej se po gjejmë gjëra të panjohura

Kalaja e Dodës nuk është larg nga qyteti i Peshkopisë, vetëm 28 kilometra por nga që rruga është e pashtruar kilometrat vetëm zgjaten pambarim. Kalosh Dodë një biznesmen i njohur në metropolin shqiptar i cili është dhe pronari i makinës me të cilën po udhëtojmë e ka bërë disa herë këtë rrugë.

-Sa herë që nisem këndej, thotë Kaloshi, e kontrolloj njëherë makinën jo vetëm për karburant por dhe për ndodnjë defekt që mund të krijohet. Është rrugë mjaft e keqe dhe ka dhe të papriturat e saj. Sapo kalojmë Vleshën përpara nesh shfaqet një lumë disi i qetë dhe me pak ujë.

-Veleshica, thotë Kaloshi. Në verë kështu është i qetë por ama në dimër egërsohet dhe shpesh herë përveç tokave që përmyt ka marrë me vehte dhe viktima. Mjaft studiues vendas fjalën Veleshicë e lidhin me rrënjën e fjalës shqipe valë, vala e lumit. Bile jo vetëm nga por dhe vetë fshati Vleshë nga ky lumë supozohet se ka marrë emrin. Vlesha shtrihet poshtë majës së lartë të Stermecit në një pllajë të gjërë ku tokat e saj janë mjaft prodhuese. Njihet Vlesha me teqen e famshme të bilbilin. Kjo tek ne ka ardhur si legjendë. Tregojnë se sheh Ibrahim (atëherë sapo kishte hapur teqen në Vleshë) ka bërë fet bilbilin. Fakt është se edhe sot tek teqja e Vleshës nuk dëgjohet zëri i bilbilin. Me sheh Ibrahim lidhet edhe një legjendë tjetër. Thonë se dhe uji e ftohtë dhe mjaft kurativ të Vleshës e kemi dhuratë nga vetë sheh Ibrahim. Ai bëri një lutje dhe pas pak shpërtheu uji. Në fillim me ngjyrë të kuqe dhe sapo bëri një kurban uji filloi të dalë nga toka i pastër si kristalli. Vlesha nuk është futur në histori vetëm me legjenda. Nga ky fshat i vogël kanë dalë një plejadë e madhe intelektualësh që sot punojnë dhe drejtojnë në sektorë të ndryshëm të vendit tone si ushtarak, inxhinier, mjek, ekonomist, politikanë e biznesmen të suksesshëm. Edhe vetë universitet të kishte patur Vlesha besoj se nuk do të kishte nxjerrë më shumë intelektual.

KALAJA E DODËS MES EMRAVE SHQIP DHE ATYRE TË HUAJ

Veleshica është kufiri ndarës mes Ujës e Mujës dhe Kalasë së Dodës. Matanë Veleshicës shtrihen të gjithë fshatrat e Kalasë së Dodës me emra shqip por dhe të huaj si Shullan, Çernjevë, Radomirë, Sterdok,



Rade, Tejzë, Ploshtan Ceren, Vasie. Vite më parë me ish mësuesin tim Xhemal Domi banor i kësaj zone kisha bërë një bisedë për emërtesën e emrave të fshatrave të Kalasë së Dodës. Sot që po shkella vetë iu ktheva kujtesës së asaj kohe. Shullan, vjen nga fjala shqipe që do të thotë vend i ngrohtë, që e kap dielli. Çernjevë fjalë sllave dhe ka kuptimin e majta e zezë, por që populli i ka vënë emrin e ri shqip Uj mirë. Radomirë sllavisht dmth rod i mirë, njeri i mirë, paqësorë. Shumë veta fjalën Radomirë e lidhin dhe me fjalën shqipe ruda e mirë nga raca e deles rudë që kjo zonë e ka më të preferuarën. Tejzë është fjalë shqipe-matanë-tej. Sterdok - shqip emër fisi doku i hershëm, doku i lashtë, stërdoku. Ceren-sllavetokë e zezë. Rade shqip emër fisi Rada. Ploshtan - shqip anash (ndodhet anash Kalasë). Vasie emër njeriu (ortodoks) Vaso.

-Tashmë banorëve të Kalasë së Dodës nuk u bëjnë përshtypje emrat, thotë Kaloshi, qofshin ato dhe sllav. Dihet se pushtuesit edhe emrat e fshatrave i përkthenin sipas vendeve që u ngulën. Këtu kudo që shkelën nëpër këto fshatra ndeshesh mes legjendës dhe realitetit. Në Kala të Dodës kanë ardhur mjaft studiues dhe albanolog të huaj si Hanni dhe Jastrebovi, kanë shkëlur me dëshirë e mirë që të shikojnë gjurmët e hershme të kalasë. Në fakt këtu nuk ka kala. Është vetëm një kodër që nuk duket asnjë lloj rrënoje e lashtë.

PO SI I MBETI EMRI KALA E DODËS DHE KU NDOHET AJO?

-Shumë veta e lidhin emërtesën me emrin e fisit Doda, tregon Kaloshi i cili dhe vetë është nga i njëjti fis. Tregojnë se nga fisi Doda kishte qenë një plak shumë i zgjuar i cili kishte jetuar më shumë se njëqind vjet. Ky ndante pleqni jo vetëm në Lumë e Dibër por dhe matanë në Rekë. Shkojmë tek Doda, Doda është kala dhe kështu dalngadalë i mbeti emri Kalaja e Dodës. Ka dhe variante të tjera. Tregojnë të moshuarit se këtu në fakt ka patur kala. Një plak nga fisi Doda rrinte roje tek porta e kësaj kalaje. Më vonë filluan ta quajnë kalaja e Dodës. Këtu janë vetëm hipoteza se në fakt

sipas mjaft studiuesve vendas gjurmët e Kalasë së Dodës janë gjetur pranë fshatit Vilë.

JO VETËM BARINJË, POR PUNËTORË DHE MIKPRITËS

E gjithë zona e Kalasë së Dodës është një reliev mjaft i thyer por bukuritë që i ka falur natyra e bën këtë trevë nga më të bukurat në vend sidomos në stinën e pranverës kur fillojnë e çelin lulet dhe në verë. Njerzit janë puntor dhe mjaft mikpritës. Jetesa gjithmonë këtu ka qenë ndryshe me zonat e tjera. Këtu ndryshe është dhe veshja, ndryshe dhe dialektet, ndryshe dhe doket e zakonet, ndryshe dhe folklori aq i pasur. Për bujarinë dhe mikpritjen e banorëve të Kalasë së Dodës ka shkruar dhe Hanni. Nuk kanë pritur asnjëherë banorët e kësaj zone nga qeveritë kushdo qofshin ato se ndoshta kujtohen për Kalanë e Dodës, as nuk kanë qëndruar me sy nga qielli se mos bie shi. Për vetë bjeshkët e shumta që kanë dhe ujin e ftohtë janë marrë gjithmonë me mbarështrimin e bagtive. Askush nuk pret se mos shteti fal ndihmë ekonomike. Këtu çdo familje ka mbi 50 kokë bagti të imta ku në verë i kullosin në bjeshkët e tyre dhe në dimër shtegtojnë në vende të ngrohta duke marrë toka me qera.

-Vite më parë tregon Kaloshi barinjët e Kalasë së Dodës shtegtonin deri në Selanik. Këtu mërgim tjetër nuk njihet. Mërgim quanin ditën që në fushën e Korabit tufat e bagtive shoqëruar nga djemtë e Kalasë së Dodës shtegtonin larg.

-Ja matanë është një toponim disi i çuditshëm guri i mollëve. Këtu mblidheshin vashat e reja dhe u jepnin mollë barinjëve të cilat i kishin ruajtur nëpër sepete. Sot në Kala të Dodës shteti nuk ndjehet. Këtu dikur ka patur spital, sot jo, ka patur shkollë të mesme sot jo. E banorët e kësaj zone janë mësuar me mos prit shumë nga shteti. Të gjithë janë vetëpunuar. Dikush me bagti e dikush ka blerë mjet transporti duke zgjidhur edhe transportin për fshatin. Nga metropoli shqiptar çdo ditë mjaft furgon nisen drejt Kalasë së Dodës. Dikush ka hapur baxho për grumbullimin e bulmetit e dikush merret me mbledhjen e bimëve mjeksore të cilat janë aq të njohura në këtë zonë.

Kryetari i komunës Bashkim Ahmataj një djalë i ri me profesionin e mjekut shprehet:

-Megjithatë këtu ka mjaft probleme sociale shumica janë vetë banorët ato që i zgjidhin. Problem madhor është infrastruktura. Nëqoftëse shteti do të kishte investuar sado pak për Kalanë e Dodës kjo zonë mund të kthehej në një park të madh turistik Turistët nuk i kanë munguar Kalasë së Dodës jo sot por dhe vite më parë por infrastruktura ka mbetur një kërkesë e vazhdueshme e këtyre banorëve të urtë, arsimdashës, puntor dhe mjaft mikpritës. Në Kala të Dodës nuk mungon asgjë për ta kthyer këtë zonë në një vend me ta ardhura të mëdha nga turizmi malor që mund të zhvillohet në një të ardhme. Fusha e Korabit me portat e saj është një mrekulli që natyra vetëm këtu e ka falur. Uji i ftohtë që nuk gjendet në asnjë vend tjetër i cili furnizon me ujë të pijshëm dhe vetë qytetin e Peshkopisë, një peisazh i rrallë që të shfaqet parasysht në çdo fshat të Kalasë së Dodës, klima e veçantë dhe mjaft kurative, toponimet dhe vendet historike që mund të vizitohen, janë këto dhe mjaft të tjera që e gjithë zonë e Kalasë së Dodës mund të krijojë mundësitë për turist të ndryshëm në stinën e verës por kjo bëhet vetëm kur shteti të kujtohet se këtu mes maleve ka një mrekulli të rrallë ku vetëm infrastruktura mungon e pastaj mund të kthehet në një vend që turizmi flet ndryshe. Këtu shumë gjëra lidhen mes mrekullive të natyrës dhe legjendave, mes realitetit që shikojmë dhe të padukëshmes. -Shumë shpejt njerzit do ta braktisin detin me rërën e tij dhe do t'i kthehen klimës dhe bukurive të maleve tona, thotë Bashkimi. Ja Thethi, Valbona, Kelmendi, Dajti, Qafë-Shtama frekuentohen çdo vit. Njerzit kanë nevojë dhe për këtë klimë e cila bashkë me ujin e bjeshkëve bëhet mjaft kurative, por kjo të paktën për Kalanë e Dodës do të ndodh kur shteti t'i kthejë sytë nga kjo zonë rrethuar me male dhe e braktisur nga shteti.

TOPONIME DHE LEGJENDA NGA MË TË NDRYSHMET

Këtu në Kala të Dodës edhe toponimet e shumta kanë të

veçantën e tyre, tregojnë historinë e kësaj treve. Kisha e Tallamazit për të cilën flet dhe Hanni ku rrënojat e fundit tashmë janë shkukur nga dora e pandërgjegjshme ku ka mbetur vetëm toponimi. , ura e qytetit, punajri, liqeni i zi, kalaja, pel-lazg, përroi i keq, fusha e Korabit, gropat e frikshme, rrasa e hajdutëve, guri i mollave etj. E këto toponime i pamë të gjithë nga afër. i pamë nga afër dhe na kujtonin një të largët Përpara nesh shtrihet një fushë disi e vogël e gjelbëruar dhe rrethuar me drurë të lartë

-Punajri i thonë vendasit, thotë Kaloshi por ndryshe kjo quhet dhe panairi. Vite më parë këtu bëhej panairi i bagtive për të gjitha viset e ballkanit. Sot në fakt nuk besohet si realitet por fakti kështu ka qënë. E shpesh herë vendin e parë e ka zënë delja rudë e Kalasë së Dodës. Ja dhe përroi i keq. Kjo ka ardhur si në formë legjende. Tregojnë se nga ky përrua njëherë humbi një fshat shumë shtëpi ndaj i mbeti dhe përroi i keq Kaloshi si një ciceron i mirë tregon për fushën e Korabit e cila ndryshe me lëndinën e lotëve në Korçë u kthye në një vend ndarje dhe takimesh, përcjellësh dhe pritjesh, lotësh malli dhe lot gëzimi. Liqeni zi një vend i mbuluar me mister, i mbushur me legjenda të ndryshme. Kështu i mbeti nga mallkimi që i bënë për mbytjen e një nusje të re. Legjenda thotë se liqeni stolitë e florinjta të kësaj nusje i nxorri poshtë aty ku sot është kroi i mirë. Ky krua në fakt ka ujë të rëndë kur e pi por ama udhëtarët të ndryshëm ndalojnë, çlodhen dhe sejcili le nga një penjë nga rrobat e tij. Kjo lidhet me be-styntinë e hershme se ndoshta ajo nusja që u mbyt në liqenin e zi sot sjell mbarësi për udhëtarët e ndryshëm. Tek liqeni i zi ka dhe një toponim tjetër. Guva e gjarprit i thonë. Edhe kjo legjendë. Këtu lindi miqësia mes gjarpërit dhe një fshatari nga Kalaja e Dodës i cili punonte me parmendë tokën tek liqeni i zi. Ky i çonte çdo mëngjez gjarpërit tek guva tasin me qumësht dhe ai i jepte një flori, por miqësia u prish shpejt nga lakmia e djalit të ri për të pasur pushtet mbi këtë guvë të mistershme. Kudo që shkelën nëpër Kala të Dodës mahnitesh. Është vetë ky reliev që udhëtarin që shkel për herë të parë e mahnit me bukurinë të rralla. Kalaja e Dodës është një ekonomi e madhe megjithatë pas viteve nëntëdhjetë mjaft familje janë shpërngulur si në Tiranë, Durrës, Lushnjë e pse jo dhe jashtë kufijve të vendit tonë. Janë mbi 900 veta që punojnë dhe jetojnë vetëm në Londër ku shumica prej tyre ka krijuar dhe familje. Fakt është se djemtë e Kalasë së Dodës kudo ku kanë shkuar janë prapë mjaft të lidhur me vendlindjen. Kthehen shpesh si zogjtë shtegtarë dhe kanë dëshirë të madhe të investojnë, t'ja ndryshojnë sado pak pamjen. Një vilë e bukur me arkitekturë të tipit perëndimorë. -Është e fisit Lita, thotë Kaloshi, një djalë nga ky fis i njohur pas një emigrimi të gjatë erdhi dhe investoi edhe këtu.

(Vijon në faqen 11)

Mërgimtarët kërkojnë të kontribuojnë financiarisht për vendlindjen

“One USD for Dibra”

Ideja që çdo kurbetçar të kontribuon me nga një dollar amerikan, në muaj, është e mërgimtarëve të Italisë dhe Amerikës, por ka gjetur mbështetjen edhe të dibranëve që jetojnë në Kosovës, Shqipëri dhe disa qytete të Maqedonisë

Nga LAURA PAPERANIKU

Dibër, 20 gusht – Një shumë modeste, prej një dollari amerikan, është “taksa” që mërgimtarët dibranë ja kanë caktuar vetes si obligim moral për të ndihmuar financiarisht vendlindjen. “Është obligim i joni moral që të gjejmë forma për të ndihmuar këtë qytet. E ndjej këtë si borxh të cilin ia kam Dibrës”, thotë Gazmend Kerkuti, i mërguara para shumë viteve në Amerikë. Kështu shprehet edhe Olloman Goreca, i cili jeton në Itali.

Ideja për gjetjen e mekanizmit, me të cilin në mënyrë të organizuar do të ndihmoheshë financiarisht Dibra, lindi nga një grup të rinjsh gurbetçarë që punojnë në Itali dhe Amerikë, mirëpo ka gjetur mbështetjen edhe të atyre punojnë dhe jetojnë në shtete e tjera të Evropës, Kosovës, Shqipëri dhe disa qytete të Maqedonisë. Artan Piperku, i cili jeton dhe punon prej disa viteve në Prishtinë është i mendimit se nga një dollar në muaj, nuk duhet të ndajnë vetëm dibranët e Amerikës dhe Evropës, por, sipas mundësive, secili që nuk jeton në Dibër. “Është një shumë e cila nuk e dëmton askënd, mirëpo me të cilën mund të bëhen shumë punë të mira për Dibër”, pohon ai.

Grupi nismëtarë, për normalizimin e

kësaj ideje, të dielën ka zgjedhur edhe organet e përkohshme të shoqatës, e cila është propozuar ta mbajë emrin “One \$ for Dibra”. “Do të punojmë me përkushtimin më të madh, që brenda afateve kohore ta vëmë në jetë këtë iniciativë fisnike të gurbetçarëve”, pohon Esat Ushtelena, koordinatori i grupeve punuese për hartimin e Propozim-Statutit, Propozim-programin dhe skemën e qarkullimit të parave. Sipas tij, të gjitha këta dokumente, do të nxihen në debat publik, në faqen e internetit “dibra.org”, e cila mirëmbahet nga një grup entuziastësh dibranë. Janari i 2008-ës, planifikohet ta gjejë Shoqatën të konsoliduar me të gjitha organet udhëheqëse, me një të punësuar dhe me zyrën e saj.

Me të hollat, të cilat do të grumbullohen nëpër kontot bankare të shteteve ku ka jetojnë dibranë, do të menaxhon Këshilli drejtues. Ky, këshill do të përbëhet vetëm prej personave që jetojnë në Dibër, kurse pritet të formohet edhe një Këshill mbikëqyrës, i përbërë nga mërgimtarët.

Në Shtete e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropë thuhet se jetojnë mbi 15 mijë dibranë, ndërsa nuk është i vogël as numri i atyre që jetojnë në Kosovë, Shqipëri, apo Shkup dhe Tetovë.



Mërgimtarët duke biseduar për projektin

DIBRA E MADHE BËHET ME GALERI TË ARTEVE Banja e Re - Hamami i qytetit, në funksionim të artit

Piktori Sabit Bocku, është i pari që hapi ekspozitën e tij në këtë galeri, i cili nëpërmjet 24 tablove të ekspozuara dydimensionale dhe 5 tredimensionale, paraqet të kaluarën tonë nëpërmjet personifikimit të oxhaqeve, ku me elemente figurative dhe metaforë artistike, shpreh të kaluarën e qytetit. Në kuadër të manifestimit “Ditët e Kulturës-Dibra 2007”, për herë të parë në historinë e Dibrës, në praninë e artdashësve, u hap Galeria e Arteve në këtë qytet. Kjo galeri tashmë është vendosur në ambientet e Banjës së re-Hamamit të qytetit, i cili është rikonstruktuar dhe në vend të shfrytëzimit si banjo do të shfrytëzohet si vend ku piktorët do t’i ekspozojnë punimet e tyre artistike. Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës, me këtë rast theksoi: “Ndjehem shumë i lumtur që ky objekt me vlera kulturore-historike, u shpëtua nga shkatërimi dhe tani do të jetë në funksion të prëzantimit të vlerave artistike të piktorëve nga qyteti dhe vendet tjera. Rikonstrukcioni i këtij objekti u bë me angazhimin e pushtetit vendor dhe ndihmës financiare të Ambasadës së Holandës në Shkup”. Prof. Petrit Damani, duke folur për rëndësinë e këtij objekti, shtoi: “Kjo galeri moderne do ta shtojë begatinë artistike të qytetit tonë e më gjerë, sepse me vënien e saj në funksion, që sot fillon konkretisht kontakti i artdashësve me krijuesit e veprave artistike. Piktori ynë Sabit Bocku, është i pari që do ta hapë ekspozitën e tij në këtë galeri, i cili nëpërmjet 24 tablove të ekspozuara dydimensionale dhe 5 tredimensionale, paraqet të kaluarën tonë nëpërmjet personifikimit të oxhaqeve, ku me elemente figurative dhe metaforë artistike, shpreh të kaluarën e qytetit”. Piktori Sabit Bocku, i cili po krijon piktura disa dekada, shpjegoi tematikën e veprave të tij me ciklin “Oxhaqet”, që simbolizon zjarrin, ngrohtësinë, dritën, afërsinë, begatinë, familjaritetin, parësinë dhe mikpritjen. Njeriu,

sipas tij, që nga lashtësia adhuron zjarrin si perëndinë e vet, duke e ruajtur me fanatizëm si dicka të shenjtë nga aspekti i dobisë, por edhe nga rreziku që mund të shkaktojë. Për shkak të zjarrit lindi edhe votra e zjarrit, e cila në fillim që vendosur në mes të dhomës dhe më vonë në ballë të dhomës, duke i lënë një vrimë vertikale nga ku dilte tymi mbi çati. Kjo skutë u pagëzua oxhak. Dikur oxhaq mund të ndërtonin vetëm familjet e pasura, sepse oxhaku ishte edhe simbol i familjeve me pozitë të lartë në shoqëri. Disa fise dibrane që zotëronin pushtet në zona të ndryshme janë qua-



Gjatë përrimit të Galerisë së Arteve

DIBËR - BETONET PO E MBULOJNË TOKËN BUJQËSORE Urbanizmi më shumë preferon fushën se sa kodrat

Secili që shikon qytetin e Dibrës nga pozicioni i kodrave, do të dëshprohet kur vëren se si ndërtime të shtëpive kanë gllabëruar dhe po gllabërojnë pamëshirshëm sipërfaqet e tokave bujqësore. Kjo pakujdesi urbanistike zotëroi sidomos gjatë sistemit të kaluar monist dhe është duke vazhduar edhe sot e kësaj dite. Të gjitha kuvendet komunale në kohën e monizmit dhe këshillat e komunës në gjashtëmbëdhjetë vitet e demokracisë, në mënyrë të pamëshirshme e të pandërgjegjshme kanë aprovuar dhe po aprovjnë plane urbanistike, gjithnjë në dëm të sipërfaqeve bujqësore dhe për t’i mbuluar ato me objekte banimi. Kjo ka ndikuar që deri më sot mbi bazën e këtyre planeve urbanistike qindra hektarë të fushës së Dibrës në cilësinë e tokave bujqësore, tashmë janë shndëruar në toka ndërtime.

Shumë pak sipërfaqe të lira bujqësore kanë mbetur në lokacionet Tylbe, Uraniku, Taraniku, Fusha e Qernanicës, Fusha e Aeroplanëve, Pasraspuri, etj.

Si rezultat i kësaj në Dibër më shumë është zhvilluar ndërtimtaria se sa bujqësia, blektoria apo industria.

Kjo ka bërë që në Dibër të ngec dukshëm zhvillimi ekonomik dhe si

pasojë e kësaj zotëron një papunësi enorme, ku të rinjtë dibranë shpëtimin e shohin vetëm në rrugën e mërgimit.

Po t’i hedhim një sy historisë së qytetit të Dibrës në kulmin e lulzimit të saj, do të shohim se banorët e atëhershëm më shumë kanë preferuar që objektet e tyre të banimit t’i ndërtojnë nëpër kodrat e qytetit, ku edhe sot e kësaj dite gjenden rrugicat me kallidërma dhe muret prej guri. Edhe bejlerët e atëhershëm kanë preferuar që kullat e tyre t’i ndërtojnë nëpër kodra. Edhe Mojsi Golemi kullën e tij e ka patur te kodrat e bejlerëve. Gjyshërit tanë urbanizimin e tyre e kanë zhvilluar më shumë nëpër kodra, e para, për arsye strategjike dhe pamje mahnitëse, dhe e dyta, për ta ruajtur dhe për ta punuar tokën bujqësore frytdhënëse.

Me qëllim të shpëtimit të asaj pak toke bujqësore që ka mbetur, një pjesë e dibranëve janë të mendimit, se ndërtimi i qytetit në të ardhmen duhet të orientohet drejt kodrave, nëse dëshirojmë ta mbrojmë maksimalisht tokën bujqësore, sepse toka bujqësore herë-dokurdo sërish mund të shndërohet në tokë ndërtimore, ndërsa godinat me betonarme, nuk mund të japin bukë dhe vështirë se mund të bëhen toka bujqësore. /R. Torte



itur Oxhaku i Hoxhollajve, Karahasana- jve, Hysenagollajve dhe Xhilagajve. Oxhak në shtëpi nuk mund të vinte çdokush, por sot kohët kanë ndryshuar dhe çdo shtëpi ka oxhaku e vet”. Vizitori duke parë këto punime mëson për rëndësinë që ka zjarri për të ecur njeriu përpara, si edhe për dënimin që duhet ta pësosh ai që e keqpërdor zjarrin, sepse zjarri sa është i dobishëm, aq është edhe i rrezikshëm. Vizitori mëson për rëndësinë e ruajtjes së oxhaqeve dhe të bashkimit të oxhaqeve në aspektin organizativ shoqëror, siç ishte në kohën e Skenderbeut, kur oxhaqet paraqisnin grushtin e fuqishëm të bashkimit, por edhe si shprehje e furtunës dhe mospajtimeve, si shprehje e ngujimit nga vrasjet dhe hakmarrja dhe si simbol i shuarjes së oxhakut, që simbolizon shuarjen e familjes në aspektin e pozitës dhe nga shkaqet e mërgimit.

Rexhep Torte

11 vjet veprimtari të shoqatës Ekologjike “Deshat” Atli Dema: Ja projektet tona për ruajtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor në Dibër

Nga VALBONA ZUNÇE

Të flasësh për të kaluarën do të thotë të aludosh, të shpjegosh të sotmen, diagonalja zhvilluese e së cilës është plot batica e zbatica. E themi këtë sepse ky qytet i shtrirë si amfiteatër mbi liqenin piktoresk, ka tërhequr vëmendjen nëpër kohë.

Me Kryetarin e Shoqatës Ekologjike “Deshat” Atli Dema qëndronim në verandën e “Taverna Camit”, duke shijuar shijen e një kafeje, sodisnim liqenin e Dibrës që ndahet mospërmas nga uji ftohtë i Radikës, për t’u bashkuar pastaj me Drinin e Zi, që shpeshherë është dëshmitar i kalvareve dhe shpërlarjes së gjakut ndër shekuj. Pikërisht nga ky liqer shpërthen befasi Atliu, krijohet kufiri i dy popujve me një gjuhë e shkrimlexim, ... Heshtja ndjehej si një armë që vret... Ishim në pritje të diçkaje... duke pritur vrojtonim shishet e plastikës që si pulbardhat shëtisnin lehtë nëpër liqer nga puhizë e pasdites së korrikut. Në këtë atmosferë-meditimi heshtëm bashkë duke futur thellë mendimin në virgjërinë e natyrës së brishtë ndaj së cilës nuk i është vënë dorë e butë ndërtuese, por vetëm dorë shkatërrimi e dëmtimi. Sot Dibra mbetet margjinave në mëshirën e fatit të vet. Në Dibër për çdo ditë rritet numri i të papunëve, dhe në këso kushtesh rinia dibrane në pamundësi të mbajë ritmin e kohës detyrohet të merr rrugën e mërgimit. Dibra nëpër shekuj njihet si një ndër rajonet me numër më të madh të mërgimtarëve në hapësirën e shqiptarëve të Maqedonisë. Në të kaluarën dibranët njiheshin si mërgimtarë sezonal duke operuar me mjeshtri veprimtarinë e ndërtimit në ndërtimet me gur si dhe në përpunimin e drurit, me mjeshtërinë e tyre kanë ngritur një sërë institucione kulturore si dhe në ndërtimet private nëpër vende të ndryshme të botës, por në Dibër nuk arritën të ndërtojnë thujse asgjë. Ndërsa sot qytetarët e saj kanë marrë botës në sy. Në këta mendime dy shtëllunga tym i dalin nga goja njeriut të penës e avokatit të qytetit që me zërin e tij bariton pareshtur gjendet në radio e televizion, njeri që zërin e arsyes e ka çuar lartë deri në eter për të mbrojtur parime e vlera sa demokratike, po aq edhe për Dibrën e tij të dashur. Për disa momente nxjerr nga çanta një bllok dhe një laps sepse mendoj që te ne gazetarët përveç emocioneve duhet të shprehim edhe përshtypjet e të tjerëve, dhe për këtë njeri të palodhur që kam përballë meje ta intervistoj.

Një ankth i lehtë na shoqëri të dy. Ndaj me përimtimin kërkues brenda nesh sikur e luftonim misterin. Ishte vërtet një çast hezitues. Të bindur se çdo gjë, gjer më tani i takonte të kaluarës, “pulëbardhat” na dukeshin se i luhatin “erërat e kohërave” duke i dërguar larg, larg...



Gjatë qershorit dhe korrikut, stina e verës krijoi kushte për shijimin e freskisë në liqenin e Dibrës, shtoi Atliu. Nga qytetarët e Dibrës këtë e kanë shijuar edhe mërgimtarët që kanë ardhur të kalojnë pushimet verore në Dibër, familjet dibrane dhe mysafirë nga qytete të tjera, dalje në natyrë në brigjet e lumit Radika, tek kisha e bukur e Shën Bigurit, e krijuar nga zoografë të njohur shqiptarë, rivierën freskuese të liqenit të Dibrës, duke e bërë atraktive dhe joshëse edhe me zënie e peshkut, që është i njohur për nga kualiteti i lartë. Kur bëhet fjalë për zënie e peshkut në liqenin e Dibrës më së shumti e shfrytëzuan shkupjanët. Për këtë specie kualitative dhe me rëndësi ekonomike pati edhe të tillë që ditët e pushimeve të majit insistuan që t’i shfrytëzojnë edhe në përfitim, pra duke zënë peshq me mjete të ndaluara ligjërisht, por edhe forma shkatërruese, që janë të njohura deri më tani. Përkundër kësaj,

anëtarë të shoqatës Ekologjike “Deshat” në Dibër dhe anëtarë të Shoqatës Sportive të Peshkatarëve “Trofta”, që janë edhe koncesionerë të liqenit të Dibrës, me një intensitet të shtuar zhvilluan eko-patrullën për ndërprerjen e dukurisë së vjedhjes së peshkut me rrjeta respektivisht nica dhe mjete të tjera shkatërruese.

Kështu që vetëm brenda dy javëve në liqenin e Dibrës janë zënë 17 nica të cilat janë sequestruar.

Shoqata ekologjike “Deshat” në Dibër tani është më e njohur në vend për kontributin dhe angazhimin e saj të dhënë në përparimin dhe ruajtjen e ambientit jetësor, është duke implementuar me mjaft sukses projektin “Eko-patrulla me Ekorizim” të mbështetur nga Qendra për vetëdihmë të komunitetit CSHI, sektor i USAID-it, i cili ka pajisur shoqatën me një skaf moder dhe tërë materialet logjistike të nevojshme për ekopatrullë si me radio lidhje, dylbinë dhe mjete të

tjera, që mendoj se janë më se të nevojshme për implementimin e vazhdueshëm të këtij projekti në përparimin dhe ruajtjen e ambientit jetësor në liqenin e Dibrës.

Këto ditë kemi pasur përkrahje për ndërprerjen e vjedhjes së peshkut nga forcat e njësitit të specializuara “Alfa”, të cilët kanë treguar efikasitet të madh në ndërprerjen e vjedhjes së peshkut. Po ashtu, edhe me anëtarë të shoqatës sportive të Peshkatarëve “Trofta” si dhe me anëtarët e Klubit të Kajakëve “Radika”, këto ditë do të pastrojmë tërë shishet e plastikës nga reviera e liqenit të Dibrës.

Pastaj, shton Dema, theks i veçantë parashihet ngritja e një kampi patrullues në liqenin e Dibrës, si dhe ngritjen e një qendre për shumimin e peshkut në liqenin e Dibrës, për të cilën presim përkrahje nga ministria e bujqësisë dhe ajo e ekologjike e Maqedonisë.

Tradicionalisht, gjatë muajit prill zhvillohen dy aksione ekologjike, njëri në ditën e verës, pra më 14 prill, ku u promovohet vullnetarizmi, po ashtu më 22 prill, nën moton: toka është e jona ta mbrojmë atë, duke e shënuar ditën e tokës, u bëmë aksionin për pastrimin e plazhit të liqenit pikërisht në vendin ku qytetarët dibranë frekuentojnë gjatë stinorit të verës.

Me që masat plastike të cilat kanë një jetëgjatësi të madhe e kryesisht vijnë nga rajoni i Rekës, është duke shqyrtuar mundësinë që të vihet një barrikadë, pra pengesë që masat plastike që të mos lundrojnë nëpër liqer, por t’u ndërpriten hyrja e tyre. Kështu që për këtë ndoshta do të jenë të nevojshme edhe mjete materiale, për të cilat shpresojmë që do të gjejmë edhe donatorë, e që është me mjaft interes sepse dita ditës liqeni i Dibrës merr pamjen e vendit për hedhjen e mbeturinave dhe ndoshta në të ardhmen e shpejtë, ky liqer nga ndotja e madhe që po i bëhet, do të jetë i pa shfrytëzueshëm si për larje gjatë stinës së verës, poashtu edhe për kreativitet sportive.

Projekt tjetër që është duke u implementuar i shoqatës Ekologjike “Deshat” në Dibër është edhe qendra për rritur “Babylon”, ku frekuentojnë rreth 80 fëmijë në javë, qendër që është mjaft atraktive dhe e preferueshme për fëmijët dhe të rriturit e Dibrës. Këtu në këtë projekt që veprimtarinë e saj

është duke e zhvilluar gati 7 vjet e që kemi gjetur përkrahje si nga autoritetet lokale, po ashtu edhe nga drejtues së shkollës fillore “Vëllazërim Bashkim”. Gjatë kreativiteteve të zhvilluara me të rinj të kësaj qendre e në veçanti me grupin letrar, u pa që te këta të rinj kanë një potencial e vitalitet artistik e letrar, pas mbajtjes së disa mbrëmjeve poetike me letrarët e rinj dhe anëtarë të Art-Klubit, u pa që poezitë e këtyre të rinjve janë me vlera dhe me një mesazh të fuqishëm, lindi ideja që poezitë e tyre t’i botojmë. Arsyet e botimit janë të shumta, por ajo më e rëndësishmja është që poezitë e tyre të mos mbesin në letër dhe t’ju japim një forcë shtytëse që t’i publikojmë këto poezi. Përkrah përmblidhjes me poezi “Jam te kënga”, botim i shoqatës, janë botuar edhe libri me poezi të Kreshnike Serdarit dhe të Ble-ta Begut. Por këto ditë presim të dalë nga shtypi libri më i ri me poezi i Rina Turkeshit.

Tratativat e anëtarëve të shoqatës Ekologjike “Deshat” në Dibër, shton Dema, ka mbushur sepetin e aktiviteteve duke realizuar një sërë projekte të ndryshme, të gjitha këto në interes të realizimit të pikave programore me theks të veçantë në ruajtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor, si dhe në ngritjen e vetëdijes ekologjike tek të rinjtë.

Në këto mendime të ngujara “në lëmshin gordian”, instikti na preku çlirimim reporteresk. Ndaj mendimet e ndrydhura filluan të lirohen dhe të spostonen me kuptime figurative.

Në insistimin se ç’farë “bagazhi” artistik dhe angazhimi ka ky personazh i reportazhit

U ndërpreme i themi...Jo, përkundrazi desha të bëj një telefonatë.

Pra, unë si edhe krijuesit e tjerë, asocoi me fatin, vijën e jetës bile edhe atëherë kur ky fat është i ngatëruar. E dini pse e them këtë, thotë se e sotmja është e preokupuar me çështjen e personalitetit. Por, ajo që fytyrën e bën personazh është individualiteti bota e brendshme shpirtërore e tij.

Fushëveprimin e saj Shoqata Ekologjike „Deshat” e ka nisur që nga viti 1996, pra sot ajo ka mbi 11 vjet traditë dhe histori. Përkrah aktiviteteve që përmendëm më lartë duhet shtuar se me interes është edhe projekti “Plani Lokal për Veprim në Mjedis” (PLVMP) ku në një libër janë përshkruar tërë aktivitetet lokale, veçanërisht ata të infrastrukturës, që do të ballafaqohet komuna e Dibrës deri në vitin 2020, janë përshkruar dhe janë dhënë ide se si mund të zgjidhen.

Dibra me rrethinën edhe pse kanë synuar që Radika të mbetet raritet dhe Drini i Zi të jetë si një burim i tujgur, nuk ja kanë arritur gjithnjë qëllimin e dëshiruar, po ashtu edhe Liqeni i Dibrës që shquhet për troftën me florën dhe faunën, prej dite në ditë zvetnohet nga ndotja e ambientit sportive.

Puhiza e korrikut sikur nuk kishte të ndalur, por edhe fjalët e kryetarit të shoqatës Ekologjike “Deshat” në Dibër nuk u shterën, por ne ndamë dhe zhgaravitëm në letër disa nga kontributet e kësaj shoqate, të cilat mendojmë që kanë dhënë shumë në ruajtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor në Dibër.



Tek klubi i Kajakut ne Diber (kayakradika.com) u mbajten gara sportive ne te cilen moren pjese kajakiste nga Bullgaria, Greqia, Oheri, Struga etj. Ishte nje dite metevertet e bukur. Nga opinjoni personal...mendoj qe ki klub eshte me shume per ta nderuar, pasi metevertet punojne!

Foto dhe dicitura: Gazmend Kërkurti

DY OSTRENAS NE OMONIA

Nga ABDURAHIM ASHIKU

Ishin dy. Njeri ka hapur në tërë faqen e parë "Emigranti"-n kurse i dyti ndjek me sy titujt dhe shokun që i lexon ato me zë të lartë. Më tërhoqi poza e qetë dhe shprehja dashamirëse e vështrimit të tyre mbi gazetë. Nga pas pamja ishte anonime. Dukej gazeta por nuk dukeshin lexuesit e saj. U dola përpara dhe u kërkova leje që t'i fotografoja. M'u përgjigjën me mirësjellje dhe morën pamjen e parë pa u ndruajtur dhe pa atë emocion kur dikush të sheh nëpërmjet syut të fotoapararit.

Nuk më pyetën se kush isha dhe pse i fotografova. I pyeta unë me formën standarte të njohjes.

- Nga jeni ?
- Nga Dibra,
- Nga cili vend i Dibrës ?
- Nga Ostreni.
- Nga Ostreni i Madh apo nga Ostreni i Vogël ?
- Nga Ostreni i Madh.
- Ç'farë fisi ?
- Rama.

Në atë çast mëndja më fluturoi në Ostrenin e Madh, në atë fundkupe të maleve mbushur me burime kristal e gjelbrim. Njihja shumë nga Ramat e Ostrenit por mendimi nuk mund të mos ndalej tek njeri, një mjeshtër i madh i mundjes, lojës burrërore gollobordase që dasmat ka si shkollë të parë të ngjitjes drejt titujve të lartë.

- E njeh Fiqiri Ramën? - pyeta menjëherë.

- E kam vëlla - tha i pari, ai që mbante gazetën në dorë.

- E kam kushëri të parë, baballarët vëllezër - tha i dyti.

Më befason, veçanrisht i pari që e kishte trupin dy pëllëmbë më të gjatë se Fiqiri.

- Fiqiri i shkurtër, kurse ju i gjatë - e ngacmoi.

- Babai dhe nëna e kishin provë të parë - tha ai duke qeshur.

- Atë e paskan zënë në Ostren kurse ty në Testikamen, i

Më merr malli për Dibrën, për njerëzit, për malet, fushat, krotjet... Njëmbëdhjet vjet larguar, në dhe të huaj, çdo njeri që takoj, çdo telefonatë që më vjen në celularin tim 0030 6938103747 në pozicionin e gazetarit të gazetës "EMIGRANTI", më zgjon mall. Atëhere marr pemën e shkruaj, bisedoj nga afër dhe nga larg me dibranët...

Këtë cikël shkrimesh, botuar në "Emigranti" për Greqinë, po e përcjell "Rrugës së Arbërit" me dëshirën e madhe që një ditë, brezi që po rritet, të niset në mëngjes nga Tirana, të pijë një kafe në Dibër dhe të kthehet në Tiranë pa e thyer orarin e punës zyrtare.

Me respekt e dashuri
ABDURAHIM ASHIKU
Athinë, gusht 2007
e mail a_ashiku@yahoo.gr



them duke nënkuptuar ultësirën e fushëzës së Ostrenit dhe lartësinë e malit të Testikamenit.

- I njihke mirë ato vende - më thonë të dy me një fjalë duke qeshur me shpirt. - Mos jeni edhe ju andej ?

U tregova emrin dhe mbiemrin. Më tundën gazetën që kishin në dorë, më "tundën" edhe gazetën e kohëve të shkuara. Biseda u ngror, u bë më intime.

Vazhduam të kuvendojmë. -E keni ringritur xhaminë në qendër të Ostrenit ? - pyeta ngacmueshëm.

- Më të bukur se e para.

- Me gurë apo me beton ? - vazhdova t'i grryey.

- Me beton.

- Atëhere nuk qenka më e bukur se e para - u them - Ajo ishte e ndërtuar me gurë të gëdhendur, kishte vulën mjeshtrore të duarve të mrekullueshme të mjeshtrove të vjetër ostrenas...

Fjala u ndal tek ajo një e jetës që përbën shpirtin e gollobordasit ndërtues, tek mjeshttrat e punimit të gurit monumentet e të cilëve i gjen në kullat e Llangës, Ostrenit, Trebishtit, Okshtunit... Por më të shumtët e më madhështorët i gjen larg atyre trojeve e maleve në qendrën gjeografike shqipfolëse që po të matet përkon pikrisht me atë zonë. I gjen veçanrisht në Stamboll dhe vise të tjera të

Rumelisë. Janë kaq të veçantë, kaqë madhështorë këto ndërtime sa një historian perendimor njohës i madh i kohës së tij, pat thënë pa mëdyshje. "Nëqoftëse digjet Stambolli Dibra e ndërton të ri nga e para. Në qoftëse digjet Dibra..." E pat thënë ai rreth dy shekuj më parë, e pat thënë për kohën e tij pa e ditur se ajo thënie do të jetonte dhe jeton akoma. Dibra, e në veçanti gollobordasit, kanë qenë ndërtuesit e Shqipërisë nga Veriu në Jug. Nuk ka vepër të kohës së shkuar pesëdhjetëvjeçare që nuk ka në mure dhe kollonat e betonta djersën, kallot e duarve, mençurinë gollobordase. Nuk ka trevë të Shqipërisë që të ketë nxjerrë kaq inxhinierë popullorë e mjeshttra të ndërtimit të urave, kanaleve ujitëse, veprave të artit, hidrocentraleve etj., Heronj të Punës, sa ka nxjerrë Golloborda. Gollobordasit ndërtuan Shqipërinë kurse Shqipëria nuk e ndërtoi dot Gollobordën...

- Me familje jeni këtu ? - vazhdoj bisedën me pyetjen rutinë.

- Jo, më përgjigjen njëzëri.

- Ku i keni familjet ?

- Unë nuk e kam lëshuar Ostrenin, thotë i pari.

- Unë jam vendosur në Tiranë, thotë i dyti.

- Ju, i drejtohem të parit, vëlait të Fiqirit, nuk i qenkeni larguar traditës shekullore. Gollobordasit kanë rrahur rrugët

e tërë Ballkanit, rrugët e Bullgarisë, Greqisë, Turqisë dhe më thellë. Familjen, gruan dhe fëmijët, themelet e jetesës së tyre i kanë pasur vazhdimisht në fshatin e tyre. Gollobordasit janë ngjitur në tërë lartësitë e ndërtimeve në tërë Shqipërinë. Tek familjet e tyre vinin vetëm kur merrnin lejen ose në prag e pas Një Majit dhe 10 Korrikut, kohë kur gjatë tërë javës, nga e diela në të dielë bënin dasma e vinin në mes të tapetit të blertë dashin e të zotit të dasmës, fitues i të cilit do të ishte më i forti në mundje klasike apo të lirë. Edhe fëmijët i bënin me fushata...

- E njihke mirë Gollobordën, më thonë tashmë me një afri shpirtrore që u dilte nga zemra.

- E njoh paksa - u them - E njoh që nga Tërbaçi, Tuçepi, Ostreni, Okshtuni, Trebishti, Klenja e deri në Llangë. E kam shetit në këmbë që në ultësirën e Drinit kur bashkohet me Zallin poshtë Gjoricës e deri në malet e Klenjës dhe të Steblevës, male që kanë në duar një ndër bukuritë dhe pasuritë më mëdha të Dibrës, livadhet dhe kullotat alpine dhe pyjet ku më të mëdhenjtë shtrihen në Steblevë e Okshtun...

E pashë me sy dhe e ndjeva që u malluan. Kisha hyrë në kujtimet e tyre, ato lloj kujtimesh që lidhen me fëmijërinë, me truallin ku kanë lindur, me

malet e gërxhet ku kanë ndërjet t'u hyjnë ferrat në këmbë përmes opingave të llastikut e ku shkurreve kanë lënë ndonjë copë rrobë në kërkim të vendeve të fshehta të vendlindjes.

- Sa fëmijë keni ?

- Unë kam tre - thotë i dyti - Dy djem e një vajzë.

- Unë kam katër - thotë i pari - Kam tre djem e një vajzë. Djalin e madh, Ledion, e kam me vete.

- Me çfarë kategorie kanë lindur djemtë ? - e ngacmoi të parin.

- Me të gjashtë - më përgjigjet duke qeshur - Kategorinë e shtatë e marrin ditën që venë tullën e parë.

- Folëm - u them - por nuk u muarëm vesht. Mbollëm tërë arën e nuk i vumë degën në mes...

Qeshën të dy sa u ndritën sytë.

- Mua më quajnë Skënder Rama, tha i pari.

- Kurse mua më quajnë Xhevdet Rama, shtoi i dyti.

- Punojmë në Aspopirgos, - tha Skënderi. - Të dielat vijmë në Omonia, marrim rregullisht gazetën "Emigranti", pimë ndonjë kafe, takojmë ndonjë shok...

I dhamë dorën njeri tjetrit. I shtrënguam fort siç i shtrëngojnë ata që ndajnë dashuri dhe respekt për njerëzit dhe vendlindjet e tyre.

Omonia, mars 2007

Toponimet serbosllave të futura në trojet shqiptare

Emërtimet duhet të jenë shqip

Politika ekspansioniste ruso-serbe që për fat të keq është duke u dëshmuar edhe sot e kësaj dite me një intensitet të paparë kundër çështjes shqiptare, përkatësisht kundër pavarësisë së merituar të Kosovës, popullin shqiptar e vën para shumë detyrave imediate. Njëra ndër to padyshim është edhe zëvendësimi i toponimeve serbosllave të ngulitura në trojet shqiptare. Kjo është gjëja më sublimë, që nuk na kushton gjë dhe që duhet ta kryejë inteligjenca dhe lidërshipi shqiptar, sidomos në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë. Po ti shikojmë hartat gjeografike, ose po të bëjmë një udhëtim nëpër trojet etnike shqiptare në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë, Luginën e Preshevës, Malin e Zi dhe Çamëri, do të hasim në shumë toponime serbosllave që ta vrasin syrin dhe veshin. Këto toponime nuk kanë ardhur aqë lehtë. Janë bërë luftëra të ashpra dhe është derdhur shumë gjak shqiptarësh autoktonë. Është fakt i pamohueshëm që edhe sot e kësaj dite, në mbarë trojet shqiptare ekziston mjaft e përhapur kjo toponimi serbosllave.

Është e njohur historikisht se valët e dyndjeve sllave në trojet shqiptare kanë filluar heret. Është shumë interesante se sllavët janë treguar tepër sistematik dhe agresivë në ndryshimin e toponimisë së vendeve ku shkellnin. Kjo bëhej edhe përmes përkthimit të toponimeve vendase që i hasnin, përmes përdorimit të toponimisë kishitare orthodoxe sllave dhe for-

mave tjera. Qysh në Mesjetë në kanonikun e Car Dushanit ka patur edhe rregullat të zyrtarizuara për ndryshimin e këtyre emrave autoktone shqiptare.

Ndryshimin e toponimeve shqipe serbosllavët e kanë bërë në mënyrë të qëllimshme, të ndërgjegjshme dhe largpamëse, për të ngulitur sa më thellë rënjët sllave aty ku ata s'kanë qenë kurrë më parë. Sllavët me qenien dhe sjelljet e tyre kanë dëshmuar vuajtjen nga kompleksi. Ata janë ndje të kompleksuar nga mungesa e traditës kulturore dhe e lashtësisë së tyre historike. Me ardhjen e tyre gjatë mesjetës në trojet shqiptare, ata u ballafaquan me një qytetërim të luëzuar dhe një kulturë të lartë ilire. Të gjendur pëballë kësaj kulture të zhvilluar, sllavët domosdo e kanë ndërjet veten të poshtëruar, dhe kjo i ka shty dhe ua ka shtuar oreksin të punojnë në mënyrë sistematike dhe agresive për afirmimin e pranisë së tyre në këto troje dhe këtë e kanë arritur edhe me zëvendësimin e toponimeve shqipe me ato serbosllave.

SHQIPËRIA PLOT ME EMËRTIME SERBOSLLAVE Studimet dhe faktet flasin se kjo e keqe

e ka zanafillën nga koha e Car Dushanit, i cili pushtoi trojet shqiptare me dhunë, vrasje, djegie dhe tmerr të paparë, duke mos përjashtuar as edhe Shqipërinë dhe duke krijuar një territor të okupuar për të pasur pranë edhe detin. Kjo dhunë e madhe e ushtruar ndaj popullatës vendase, bëri që të shpërngulet me forcë një numër i madh shqiptarëve nga trojet e veta për në Greqi e gjetiu. Serbosllavët brenda një kohe shumë të shkurtër arritën ta vendosin toponiminë në fushat, malet dhe qendrat shqiptare të banimit, duke shkëlur mbi gjuhën dhe psikologjinë e popullit autokton. Serbosllavët kur e pushtonin dhe sundonin një vend, pa marë parasysh se ai vend kishte toponiminë e vet, ata zbatonin taktikën e konceptuar të mentalitetit të tyre të vrazhdë të emërtimit të toponimeve me gjuhën e tyre sllave.

Për fat të keq kjo toponimi sllave në trojet tona është trashëguar gjatë dhe është e pranishme edhe në ditët e sotme. Flitet se në kohën e Mbretit Zog ka patur disa nisma që toponimet sllave të zëvendësohen toponime burimore shqipe, por faktori politik dhe shkencor nuk është treguar shumë vigjilent në këtë drejtim.

Vizita ime ditë më parë në Shqipëri bëri

që për të satën herë të lexoj shumë pllaka metalike të vendosura përbri rrugës e që kanë të shkruar toponimi emërtimesh serbosllave. Kjo më shtyri të blej edhe një hartë të rrugëve automobilistike, ku nga jugu në veri të Shqipërisë, figurojnë emërtimet Finiq, Lukovë, Brathaj, Selenicë, Çorovode, Potom, Novosellë, Patos, Babica e Madhe, Kapaj, Bulgarec, Golem, Divjakë, Lezhë, Ostren, Maminas, Krastë, Mamuras, Sillovë, Gollobërdë, Zllaticë, Dobrac, Bistricë, Bogove, Bradashesh, Dobrac, Dunavec, Morave, Orenjë, Pavlle, Pogradec, Shijak etj. Toponime të këtilla serbosllave ka edhe në të gjitha trojet shqiptare jashta trugut të shtetit shqiptar që administrohen nga shtetet fqinje.

EMRI SHQIP RUAN IDENTITETIN DHE AUTOKTONINË

Emri është elementi kryesor dhe legjitim i identitetit të një individi, një populli dhe një vendbanimi. Gjuha dhe emri janë argumentet që i japin kuptim, frymë dhe jetë lirisë së njeriut. Copëtimi i trojeve shqiptare në pesë shtete ka bërë të vetën dhe ka lënë pasojë të thella edhe në ndryshimin e toponimisë autoktone shqiptare. Çuditërisht ky fenomen me dekada është

Gjergj Qiriazhi, veprimtar i vendosur për shkollën shqipe

Nga DHORI QIRIAZI

Gjergj Qiriazhi lindi në Manastir më 1866. Ishte i biri i Dhimitrit që u shpërngul nga Tërrnova, ku u vendosën fillimisht, në Manastir ku kishte një dyqan zdruktari. Familja e tij pati 10 fëmijë, shtatë djem dhe tri vajza. Të gjithë këta morën arsim në gjuhë të huaj, kush më shumë e kush më pak. Fëmijët e parë u dërguan në kolegjin amerikan të Samokovit. Në Robert Kolegj të Stambollit vijuan në seksionin e vajzave tri vajza nga kjo familje, dy motrat e Gjeriasimit dhe Gjergj Qiriazit dhe një nga vajzat e Gjeriasimit: Stefania.

Të gjithë kanë dhënë ndihmesën e tyre për shkollën dhe përparimin shoqëror të vendit si dhe të shkollës shqipe.

Do të them diçka më tepër këtu për Gjergj Qiriazin, i cili edhe pse nuk e mbaroi Kolegjin e Samakovig, për arsye se u paraqit atje pak vonë dhe ishte në moshën për ushtar, kur ndërhyri qeveria bullgare për ta mobilizuar ushtar si qytetar i Perandorisë Otomane në Bullgari. Për këtë e la shkollën dhe pastaj u muar me veprimtarin të Shoqërisë Biblike si librashitës i Ungjillit, kryesisht në Shqipëri. Tani ky libër ishte i përkthyer nga K. Kristoforidhi dhe shkante dorë më dorë jo vetëm si doktrinë, por më tepër si libër, ku mësohej të shkruhej e të lexohej me alfabetin e shoqërisë së Shkronjave të Stambollit, ku morën pjesë: S. Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vretua, Koto Hoxhi, etj.

Në fillim në këtë veprimtarin patriotike u punësua Gjergj Qiriazhi. Atëherë ai u dërgua në Ohër dhe në Dibër, pastaj edhe në disa qytete të tjerë si Vlora, Shkodër etj.

Në Manastir ky veprimtar pati njohje edhe me konsullin austriak, August Karlin, në Manastir me anën e të cilit mori ndihmë për të hapur në Dibër tri shkolla shqipe nga vitet 1905-1907, por ato shkolla u luftuan nga Xhon Turqit dhe gazeta e tyre "Top" që dilte në Shkup. Ajo shkruante se "shqiptarëve u duhet prerë gjuha dhe jo t'i lejojme të shkruajnë shqip".

Gjergj Qiriazhi haset dendur në gazetën shqip të Manastirit dhe të Kostancës,

ku i bënte jehonë luftës për identitetin tonë kombëtar dhe për të fituar të drejtat tona. Në të vërtetë ai duhet ta ketë ditur që në Konferencën e paqes që u mbledh në Vjenë më 1867 për restriksionet që pësoi. Turqia nga lufta Ruso-Turke e atëherëshme si dhe detyrimet që kishte kjo e fundit për të lejuar arsimin mbi baza të gjuhës kombëtare të popujve që Perandoria kishte nën sundim. Dihet se Turqia deri atëherë lejonte shkolla mbi baza fetare, d.m.th. të gjithë myslimanët duhet të mësonin në shkollat turke, dhe të gjithë të krishterët në gjuhën greke, të çdo kombi qofshin. Qysh në vitin 1867 edhe shqiptarëve u kishte lindur e drejta nga ky vendim i Fuqive të Mëdha që të çelnin shkolla në gjuhën amtare. Mirëpo kundërshtitë e zaptuesit dhe e disa të shiturve, e penguan këtë proces 20 vjet deri më 1887 dhe kjo u arrit me shumë mundime. Në këto mundime u rreshtua edhe familja e Qiriazëve dhe midis tyre edhe Gjergj Qiriazhi, i cili luftoi si gazetar me artikuj në shtetin tonë që delte jashtë, por edhe si veprimtar pas vdekjes së Gjeriasimit, vëllait të tij, mori ai drejtimin e shkollës së vajzave në Korçë që u çel më 1891.

Atëherë ai iu vu punës për ta pajisur shkollën me libra dhe shkroi një fizikë si dhe mblodhi krijimtarinë e Gjeriasimit dhe të tij në dy vëllime dhe i botoi në vitin 1902 dhe viti II 1907, me titull "Krestomuca". Në vitin 1905 ai është anëtar i Komitetit të Manastirit, i cili u formua në shtëpinë e tij në Manastir, ku bëjnë pjesë shumë patriotë, midis tyre Bajo Topulli dhe Çerçiz Topulli, Mihal Gramenua, etj. Ky Komitet nxori në mal edhe çetën që bëri ato vite para Shpalljes së Pavarësisë aq bujë me aksionet e saj. Ai ishte nënkryetar i klubit "Bashkimi" të Manastirit dhe pastaj veprimtar i Kongresit të alfabetit të përgjithshëm të gjuhës shqipe që u mbledh në Manastir nga 1-10 nëntor 1908. Ai u zgjodh nënkryetar i Kongresit, përkrah 32 delegatëve që përfaqësonin të gjitha krahinat e Shqipërisë.

Nga zona e Maqedonisë, pra edhe të Dibrës vijën në Kongres dy delegatë: Hafëz Ibrahimit dhe Emin beu.

Kështu me mund e vështirësi është çarë kurdoherë rruga e Arbrit.

Toponimia lypset të vendoset mbi bazën e etnisë dhe në mënyrë të institucionalizuar. Në këtë drejtim edhe partitë politike shqiptare edhe inteligjenca shqiptare duket ta luajnë rolin e tyre konstruktiv.

Në Kosovë onomastika sllave, që më parë ka qenë shqiptare, është e provinçialisë sllave. Kishat serbe, bullgare e greke kanë imponuar onomastikën sllave në të gjitha trojet shqiptare.

Sipas informatave tona në Kosovë ekziston një traditë të hershme për zëvendësimin e toponimisë sllave me emra në gjuhën shqipe. Për shembull Kishareka quhet Lumësi, Dobërveni- Miradi, Vuçitërn- Vushtri, Uroshevac- Ferizaj e kështu me radhë. Është themeluar edhe kartoteka e minitoponimisë së Kosovës dhe mbi baza shkencore është duke vazhduar puna në këtë drejtim.

Lidhur me këtë problematikë të rëndësishme duhet mobilizuar të gjitha forcat intelektuale, administrative dhe politike shqiptare, për t'i flakur njëherë e përgjithmonë emërtimet serbosllave, këto çibanë që me shekuj po ndotin hapësirat dhe trojet tona e që s'pushojnë duke e shtuar oreksin e Serbisë dhe Rusisë për dominin territorial në trojet shqiptare. Me këtë do ta mbronim dhe ruanim identitetin tonë dhe sadopak do t'i respektonim të gjithë ata shqiptarë që u flijuan për të mbrojtur prapin shqiptar.

Rexhep TORTE

E kujtojmë gjithnjë

Meditim për "Mësuesin e Popullit" Selim Alliu

Nga SHEMSI MANJANI

Madhështia e vërtetë e disave me kalimin e viteve spikat dhe më fort, sidomos kjo kur ka qenë larg alibive politike e vlerave fallco. E vërmë këtë tek "Mësuesi i Popullit" Selim Alliu, madhështia e të cilit edhe sot spikat me vlera të veçanta edhe përse ka 30 vjet që vdekja e parakohshme e rrëmbeu duke e ndarë përjetësisht nga ne, vdekje që na dhemb në shpirt të gjithëve. Mendja e tij e kthjellët dhe e thellë, puna me pasion e kompetencë, korrektësia dhe kultura e tij solide letrare dhe shkencore, shpirti demokratik, bukuria e karakterit të tij, mbi të gjitha erudicioni i gjerë, ishin disa nga tiparet e tij që nuk harrohen nga të gjithë ata që e njohën, që punuan e drejtuan me të.

Lindi në mars 1914 në fshatin Strikean të Dibrës. Veç 42 vjetëve nga jeta e tij 63-vjeçare ia kushtoi arsimit, aktiviteti dhe kontributi i Selim Alliu shtrihet dhe tej caqeve të kohës së karrierës së tij qysh kur ishte në bankat e shkollës, edhe pasi doli në pension e deri sa vdiq.

I dalluar me fëmijët e vendlindjes që në fillore për zell shembullor, i pajisur që në internatin e Kastriotit me një ndjenjë të fuqishme dashurie për natyrën e bukur të vendit, patriotizmin e flaktë, gjuhën dhe folklorin e pasur të popullit do të shquhej në normalen e Elbasanit si një malësor virtuoz, djalë me intelekt, nxënës me talent të rrallë, një njeri me interesa të gjera për jetën dhe për profesionin për të cilin aq shumë kishte nevojë sidomos krahina e tij ku, gjer në vitet e para të çlirimit të atdheut akoma mbi 90% e popullsisë ishin analfabete. Gjatë kohës së stazhit dhe si mësues në ushtrimoren e Normales së Elbasanit në vitet 36-38, veç "provave mësimore" në revistën "Normalisti" provat më të gjalla si mësues i talentuar dhe pasionuar do t'i japë në klasë ndaj nxënësve, kolegëve dhe mësuesve të tij aq të pasionuar dhe të dashur si Aleksandër Xhuvani, i cili kishte një stim të veçantë për aftësitë intelektuale, pedagogjike e shkencore të këtij mësuesi të ri, mësuesin e ardhshëm të popullit. Të gjitha këto u duken fare qartë edhe si mësues në fshatin Pepel të Libohovës dhe si inspektor në Ministrinë e Arsimit dhe si kryemësues në fshatin Trebisht të Dibrës dhe si drejtues i shkollës në Zërqa.

Vite të tëra, mbi dy dekada, Selim Alliu i takoi të punonte si drejtues i arsimit në Dibër (Disa vite drejtues në qarkun e Dibrës ku përfshihej edhe Mati) duke filluar që nga kongresi i parë i mësuesve antifashiste që u mbajt në Korçë. Gjatë kësaj kohe u dallua si punëtor i palodhur dhe masovik i talentuar. Gjithë forcat dhe energjitë e tij, dijet dhe kulturën prej mësuesi dhe organizator ai vuri në shërbimin e popullit. Vëmendje i kushtoi shtrirjes së arsimit në zonat malore të Dibrës si dhe zgjidhjes së problemit të përgatitjes së kuadrit vendas.

Gjatë jetës Selim Alliu u shqua dhe si krijues letrar dhe veprimtar i dalluar në punën me traditat. Kumtesat e tij në sesione shkencore janë të një niveli të lartë. Krijimtaria e tij letrare e pedagogjike filloi që në bankat e shkollës normale, shumica e botuar në revistën "Normalisti" e cila për një periudhë u drejtua me kompetencë e krijimtari nga vetë Selimi. Tregimet e tij "Novela historike", "Gjaku i maleve", "Karakteret dhe zakonet e malësorit", "Atje

ku dergjen dëshmorët", "Mos u mbaj se je...", "Dashuri nane", "Agai në katund", referimet e trajtesat e tij në aktive, kumtesat për zhvillimin e arsimit në Dibër, veshjen e Zerqanit, dhjetëra shkrime të tjera të karakterit pedagogjik e historik flasin shumë për të. Me të drejtë intelektual i shquar dibran, "Mësuesi i Merituar", Astrit Hoxha (tani pensionist në Durrës) në kujtimet e tij me rastin e vdekjes së Selim Alliu shkruan: "Me gjithë kontributin e madh që ka dhënë Selim Alliu si punonjës e drejtues në sektorin e arsimit, sidomos në rrethin e Dibrës, më ka pas ardhur keq që ky njeri nuk mori rrugën e shkencës. Me aftësitë që kishte do të ishte bërë një punonjës i shquar shkencor në fushën e shkencave shoqërore, sidomos në histori e gjuhësi. Ai në këtë drejtim do të kishte bërë shumë më tepër sikur vdekja të mos e kishte marrë kaq herët".

Në vitin 1965, pas më shumë se tri dekada përkushtim në arsimin e fëmijëve e drejtimin e sektorit të arsimit dhe kulturës, ndaj tij padrejtësisht u mbajt një qëndrim i skajshëm politik. "Iu bë biografia, dhe u dërgua mësues në një shkollë tetëvjeçare fshati, larg familjes ku punoi me dinjitet duke mos u ç'organizuar për asnjë moment e rrethanë. Opinioni i shëndoshë i popullit, meritat e virtytet e tij të padiskutueshme e kthye në Peshkopi si drejtues në shkollat e mesme të qytetit, periudha këto që do të mbahen mend nga mësuesit e këtyre shkollave për arritje dhe drejtim shkencor e me kulturë në çdo drejtim. Kontribut dha Selimi kur ishte drejtor gjimnazit dhe në marrëdhëniet me gjimnazin e Dibrës së Madhe të Maqedonisë. Ja si shprehet Nevrez Manjani, zv/drejtoreshë e gjimnazit në atë periudhë për drejtor Selimin: "Kishte dëshirë të bisedojë e konsultohesh me të, me intelektualin që harmonizonte aq këndshëm seriozitetin me shakanë e hollë, mbi të gjitha njeriun me erudicion të gjerë, largpamësinë në shikimin e gjërave, me atë që nuk fliste asnjëherë për vete, që vlerësonte shumë intelektualët e që për të veprimtaria intelektuale ishte më e larta, më e vyera. Binte në sy pasioni e sjellje të hijshme edhe kur kundërshtonte. Ai që e shihte dhe e dëgjonte për herë të parë befasohej tek shpërndante njëherazi mençurinë e mirësinë. Veprimtaria e tij intelektualë, përfundon kujtimet e veta zv/drejtoresha, shfaqej plot shkëlqim në çdo bisedë deri edhe në kuvende e konferenca shkencore, në shkrime me karakter shkencor e letrar".

Në vitin 1969, në 25 vjetorin e Kongresit të parë të Arsimitarëve në Korçë, iu dha titulli "Mësuesi i Popullit". Në emrin e të gjithë të dekoruarve përsëriti mendimin e arsimitarëve të dalluar. Sa hije i pati fjala. Me këtë rast u gëzua gjithë populli i Dibrës të cilit i shërbeu vite të tëra me kaq devotshmëri. Veçanërisht ne që qeëm më pranë, që mësuam shumë prej tij. Por vdekja nuk njeh merita dhe madhështira. Ajo të rrëmbeu pa pritje e pakujtuar. Kështu ndodhi edhe për Selim Alliu në verën e vitit 1977. Kudo u shpreh dhimbje e pikëllim çka tregon se ai si intelektual i vërtetë e i kompletuar u përkiste të gjithëve.

A do të ketë Dibra intelektualë të tillë të shquar? Përgjigjen, mesazh, për këtë mund ta japim duke cituar intelektualin e madh të kombit, Rexhep Qosja: "Një popull që i nderon intelektualët e vetë dhe do t'i ketë".

të duke u parë nga shqiptarët me një indiferentizëm dhe gisaktohtësi që nuk duhet lejuar.

Kuptohet se shqiptarët që jetojnë në trojet e veta por në shtetet fqinje e kanë vështirë të marrin nisim për kthimin e toponimisë autoktone shqiptare, e lidhur me këtë kanë njëfarë arsytimi, pasi ende nuk janë duke i gëzuar të drejtat tyre legjitime. Por shteti amë Shqipëria, e cila gëzon pavarësinë e saj gati një shekull, nuk mund të gjejë asnjë arsytim pse nuk e ka filluar dhe pse nuk e ka bërë zëvendësimin e toponimeve serbosllave me ato autoktone shqiptare. Për fat të keq deri sot ne nuk kemi dëgjuar që të jetë ndërmarrë ndonjë nisim e kësaj natyre.

Organizmat shkencore shqiptare dhe intelektualët, organizmat administrative vendore, pa humbur kohë duhet të ndërmarrin një fushatë për të bërë shumçka në këtë drejtim. Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Historisë, Instituti i Gjeografisë dhe Instituti i Gjuhës Shqipe, i kanë të gjitha mundësitë për ta studjuar mirë toponominë dhe mikrotoponiminë vendase, për të gjetur e zbuluar toponimet e hershme shqipe të këtyre vendeve të zëvendësuar me toponime serbosllave dhe për t'i këthyer sërish në vendin e tyre shqip.

Këtë angazhim dhe aktivitet duhet ta marrin në dorë edhe organizmat vendore në Shqipëri dhe në të gjitha trojet e tjera shqiptare ku jetojnë shqiptarët.

Një cikël i veçantë i lirikave popullore të këngëve të mërgimit, dashurisë dhe natyrës

Nga NAIM PLAKU



Gjatë studimeve dhe hulumtimeve tona disaveçare të folklorit burimor, të trevës së Ujëmujës dhe Kalasë së Dodës në Dibër, shtrihet në pellgun e lumit të vogël të Veleshicës, nën këmbët e malit të Korabit, kishim vënë re një dukuri interesante, që mua dhe kompozitorin Përparim Tomçini na tërhoqën vëmendjen. Për të përforcuar bindjen se ne kishim të bëjmë me një cikël lirik këngësh popullore me tipare të veçanta, me mjete artistike letrare e muzikore specifike, me një ndërtim të përbashkët e shprehje të veçantë ideomocionale, u ndërmorën në dimrin e vitit 1982-1983 një ekspozitë kërkimore-shkencore nga ana e shtëpisë së kulturës Peshkopi. Duhej vrapuar me ngut, se ishte një realitet që po ndryshonte, subjekte e bartës të moshuar të folklorit dhe të këtyre krijimeve kaq të bukura e me interes, që rrezikonin të iknin, krijues dhe interpretues virtuozë të kësaj gjinie. Përcaktuam kriteret metodike-shkencore që do të ndiqeshin, mjetet që kishim në dispozicion dhe ekipi i përbërë nga muzikantët Përparim Tomçini e Ymer Seferi dhe unë për materialet letrare ia nisëm punës. Në atë ekspeditë shumë të suksesshme në këtë trevë u mblodhën dhe u regjistruan e u vunë në nota muzikore mbi 500 këngë e melodi e rreth një mijë tekste letrare nga të gjitha gjinitë e folklorit tonë.

1-Këtë radhë po ndalemi tek Këngët e Korabit. Siç thashë, kishim vënë re një grup këngësh që i bashkonë tematika, idetë, mjetet e përbashkëta artistike, vendlindja e tyre, qëllimi, mjedisi gjeografik e shoqëror, ndërtimi muzikor, origjinaliteti i tyre. Një ditë dimri ishim në konakun e Shaban Dakut në fshatin Çemjvë të Radomirës, aso kohe 63 vjeç, blegtor, me pak arsim fillor. Pasi na kishte kënduar disa këngë epike e lirike të trevës, për ta nxitur më tej, i kujtuam disa vargje të Fushës së Korabit. U tret pak në mendime dhe duke e mbushur gjoksin e madh, nxori një psherëtimë dhembjeje, që do të ishte dhe refreni i këngës që do të niste më pas: ihoooo!

-Ju dashkeni prej atyne kaikve të Korabit?

-Po, po. Ato duam... -U pamë sy ndër sy me Përparimin. Prsnim diçka.

-Dhe Shabani filloi:

Si na u dunën kepat -o, o kepat e Gramës, ihooo!

A të ka marrë malli-o, ore gjali i nanës, ihooo!

Dhe filluan të rridhnin vargjet dhe melodiat e një kënge të bukur baritore, të padëgjuar nga ne, të mbushur e përzierë me ndjenja malli e dhembjeje, erotizmi e dashurie në peisazhet e mrekullueshme pranverore që natyra u ka falur vetëm bjeshkëve, zajeve, burimeve e pyjeve të Korabit. Kështu vazhduam kërkimet tona e mblodhëm mbi 50 këngë të këtij cikli lirikash popullore. Kishim gjetur "Këngët e Korabit". Shumë prej këtyre këngëve, të plota apo të fragmentizuara, i gjejmë gjithandej në Dibër e Lumë, por siç do të shpjegojmë, djepi i këtyre këngëve është treva e Kalasë së

"Këngët e Korabit"



Dodës dhe Ujëmujës me rreth 20 fshatra këndeje e përtej Veleshicës, që nis rrjedhën e saj në bjeshkët e Korabit. Këtë e vërtetojnë toponimet që përmbajnë këto këngë: Fusha e Korabit, Kepat e Gramës, Ura e Izvirrit, Ponajri, Bjeshkët e Zojave, Kodra e Polakit, Prroi i Rade, Dera e Korabit, Livadhi i Gjatë, etj.

Gjuha është një element tjetër që e bën të besueshme vendlindjen e tyre në këtë truall. Trajtat nëndialektore dhe nuancat e kësaj të folmeje që shfaqen në leksik, në fonetikë dhe në morfologjinë e fjalëve, por edhe në strukturat e veçanta sintaksore, në rendin e fjalive dhe në elementë të veçantë artistike, tregojnë se kemi të bëjmë me krijime të mirëfillta folklorike të kësaj treve, sigurisht, pa u shpëtuar ndikimeve të mjedisit rrethor. Nga ana tjetër, gjykojmë për këtë realitet edhe nga kushtet ekonomike-shoqërore, që lindën këto krijime, ritet, zakonet, marrëdhëniet familjare të përbashkëta që kanë midis tyre këto fshatra.

2-Ato që tashmë do t'i quajmë "Këngët e Korabit" kanë një shtrat historik të lashtë, qysh kur ndodhen ngulimet e para në këta lëndina e bjeshkë të bukura, me ujëra të bollshëm e pyje madhështore, por me klimë të ashpër e dimra të papërballueshëm. Prandaj mërgimi i përkohshëm ekonomik, shtegtimi i banorëve meshkuj në muajt e dimrit me bagëtitë në Selanik, në vise të tjera bregdetare e të Jallisë (vende të ulta) gjerë në pjesën evropiane të Turqisë, ishte i zakonshëm, i përvitshëm dhe i detyruar. Ai fillonte në tetor, në Shmitër (6 tetor), sapo maja e Korabit të zbardhej nga dëborat e re dhe gjerë në Shëngjergj (6 maj) kur ktheheshin pikërisht kur bjeshkët ishin mbushur plot bar e lule. Ishte, pothuajse, një jetë gjysmë nomade, ashtu si ajo e vllahëve. Në shtëpi qëndronin gratë e fëmijët, ndonjë plak apo i sëmurë, që nuk kishte ndonjë angazhim pune. Gratë endnin në razboj qashën, një lloj stufe të trashë me lesh deleje për tirq e kuparane burrash, breza, sexhade e hira, qilima të bukur leshi për nevojat e tyre. Vajzat e rritura përgatisnin pajën, thurnin triko leshi, çorape, qëndisnin xhamadanë, jelekë, shami, etj. Gjashtë muajt e dimrit në atë mjedis monoton, shpesh të dhimbshëm, por frymëzues, nuset e reja pa burra dhe vajzat e bëshme thurnin ëndrra, shpresa, por dhe këto këngë të bukura, aty mbi tezgjah apo gjergjef,

këngë që shpesh lageshin me pikat e lotit të një vetmie të thellë. Në këtë mjedis lindën këta këngë, shpërthyen nëpër lirikë e bukura ndjenjat e nuseve e vajzave të reja së bashku me një revoltë të natyrshme, një protestë ndaj borës që kishte zbardhë majat:

*Pse m'i zbardhe majat?
Taj m'i çite thajat.* (Ti m'i nxore thingat, më plake)

3-Këngët e Korabit të frymëzuara nga ky realitet mbinin e rriteshin ngadalë në muajt e dimrit e shpërthenin së bashku me lulet në pranverë, në fund të prillit e fillim të majit, kur ktheheshin tufat e deleve nga shtegtimi me burrat apo të afërmit e tyre, ishin ato shqetësime që e reja "kta mujtë e dimrit i ka në poll t'qilimit" që "dada" i ka ruajtur në zemër për t'ia thënë djalit kur të vijë. Ishte vërtet një gëzim i veçantë. Krijohesh një pamje e mrekullueshme atyre mbrëmjeve, kur tufa me dhen e shqerra ngjitej ngadalë shpateve të bjeshkëve për të ardhur në shtëpi, kumborët që ushtonin aq ëmbël së bashku me fyellin e çobanit, deshtë që prinin në ballë, qentë që shoqëronin tufën, karvani i kuajve që vinte pas me plaçka dhe gjithë fshati që kishte dalë në rrugë t'i presë, veçanërisht grupet e vajzave të veshura bukur, që këndonin grupe-grupe majë kodrave këngët e tyre. Jehona shkonte bjeshkë më bjeshkë e shkëmb më shkëmb e gëzimi rritej.

*Hiku njeglla e Gramës, hoj me dadën-o
Hajde gjali i nanës, o me dadën-o!*

Këto këngë të nuseve dhe vajzave të reja ishin si një letër, si një lloj ditari intim, që po ua shpalosnin të dashurve të tyre të zemrës për t'u shprehur ndjenjat e tyre, mallin dhe brengat që kishin kaluar për muajt të tërë, ishte dufi i zjarrtë i dashurisë së vërtetë, që krijonte këta perla të lirikës popullore:

*Të përçolla udhës, dilber, udhës nga Tetova,
Ra njegll'e zezë, dilber, hijen ta harrova...*

...
*Seç po bije vdor e shoj,
Trolli po kalbet.
Ferexhja e gjalit,
Ku po laget?
Laget e thahet, of e njera,
Unë s'e di!
Shko, oj era e malit,
Thaja ti!*

...
*Këta muajt e gjatë,
T'i kam shkru në kartë,
T'i kam mshelë në arkë, o-ho!*

Këngët e Korabit këndohen nga vajzat dhe nuset të reja në një interpretim të veçantë, pa shoqërim të veglave muzikore. Gratë mblidhen në rreth në një vend të dukshëm, ose këndojnë edhe duke ecur. Në disa raste kemi disa grupe në fshat të mbledhura në bazë fisi, që nëpërmjet këngës edhe replikojnë, pa prekur e cënuar dikë, pra replika dashamirëse, se të gjithë kanë gëzim. Në disa shprehjen mendime me metafora e paralelizma figurative:

*-Kona rrajt kllosa
Për ta pre kosa.
-Jena tue u rrajt.
Sheqer për t'u shajt.*

Melodia është e shtruar, me pauza ritmike, është e fuqishme me një "o" të zgjatur në fund, duke i dhënë kështu karakterin e jehonës, pa shmangur karakterin mallëngjyes të saj.

*Ore zog skiftairi, ho me dadën-ooo,
Nortat kush t'i tajri, hoj me dadën-ooo?*

*T'isham dada gat, hoj me dadën-ooo
T'i tairsham pa hak, hoj me dadën-ooo...*

Këto këngë sidomos në kohët më të reja, janë kënduar edhe nga burrat, edhe në mjedise të mbyllura, të shoqëruara me vegla muzikore si fyell, kavall, dajre, çifteli. Ndonjëra edhe është praktikuar në hore për raste dasmash e gëzimesh familjare.

4-Këngët e Korabit janë lirika shoqërore të mërgimit ekonomik, të shtegtimi, si të tilla përmbajnë edhe motive dashurie duke patur parasysht moshën dhe seksin që i praktikon. Por duke kënduar në verë e pikërisht në festën e natyrës, ditën e Shëngjergjit që përkon me kthimin e bagëtive nga dimërimi, ato fare mirë tingëllojnë edhe si lirika të natyrës:

*Moj lule serezi,
Si na erdh Shënxherxhi
Me sheja për brezi.*

Një tis i lehtë e i këndshëm erotik përzier me mallin e të dashuarve i përshkon natyrshëm duke patur parasysht mjedisin tepër fanatik ku këndoheshin. Nusja e re i lan me lot alltijen, ▶

sahatin, shaminë, qestekun, etj., burrit që ka përcjellë në kurbet dhe i ka lënë shtratin nusëror thatë, (*përçolla dilberin*) që kur shkon me shtrinë i shkojnë lotët krue (*Fusha e Korabit*), që kurbeti i shkretë i përpiu duke ua bërë jetën gjithë verrini (*Si na u dunën e kepat e Gramës*), apo që i mbeti koka mbrapa qysh se u nda nga i shoqi (*Na çeli prapë thana*), etj. Shikoni si mendon heroi lirik në kulmin e vetmisë në një rën nga këto këngë:

*Mora shekën, shkova me melë xhanë,
gjali m'u vu mas:
-Lum nana, lum nana,
Çitëm tamël n'tas!
Hajde të fimë bashkë!
I thashë gjalit: Qaç!*

Nëna tregon se në shpirtin e saj është grumbulluar aq urrejtje nga mungesa e të shoqit, sa që lëshon mbi të birin dufin e dëshpërimit, duke qenë e ndërjegjshme se ata të dy janë bashkëvuajtës. Nga mungesa e gjatë e të shoqit hera-herës e bren xhelozia, dyshimi se mos ai e ka tradhtuar "*lulen e bukur e me erë të mirë*" dhe rri gju më gju me "shkinën":

*Ore zogu i qyqes,
Ku rrin e po dixhesh?
Ku rraje për verë?
-Te lulja me erë,
-Ku rraje për dimën?
-Gju më gju me shkinën.*

Nusja e re e shikon me trishtim afrimin e dimrit. Në familjet e mëdha me shumë djem e nuse, i zoti i shtëpisë caktonte djemtë që do të shkonin në shtegtim dhe nusja rrinte ngri-shkri, se shorti mund t'i binte të shoqit. Gjer tani ajo është djegur gjithmonë sepse:

*Kur ishe i vojl, (vogël)
S'kishe gjojë me folë.
Kur mbete i madhi,
S't'baite pare llafi.*

E reja që ka mbetur vetëm në shtëpi shpreh dëshirën që t'i shkojë pas dilberit, të dashurit të zemrës, bashkëshortit:

*Po na shkojnë ballonat për terma,
-Nalu, o ballon, të vijmë dhe na.
Të vajmë bashkë njer në Selanaj
T'i njëj dada dhentë vrajk e vrajk...*

Në disa prej këtyre këngëve përmenden emra konkret, të cilëve u drej-



Kostum popullor nga Kalaja e Dodës

tohet e reja dhe rrallë herë i riu për të shprehur ndjenjat e dhimshme të ndarjes si tek "*Moj Hatixhe, o dilber*", "*Ku të lashë moj Hasime*" ose:

*O Selim qehaja,
A t'ka kilosë meraja?*

5- Ajo që na bind se kemi të bëjmë me një cikël këngësh lirike janë padyshim mjetet artistike, ndërtimi i tyre, vargu, rima, figurat letrare, kompozicioni dhe vija melodike që i përshtatet aq mirë mendimit dhe ndjenjave që shpreh. Vargu më i zakonshëm është gjashtërokshi e tetërokshi, por kemi edhe 12 rrokësh, ose 8+4, etj. Si refren përdoren

pasthirrat: o, o-ho, i-ho, mjera unë, moj zanë, me dadën-o, oj lulije, etj., në fund të vargut ose në mes të tij:

*Mos e qaj me lot, oj zanë, mos e qaj me lot,
Se vajn dita e Shëxherxhit, sikur dita sot.*

Djali ose bashkëshorti asnjëherë nuk përmendet me emër në këto këngë. Kjo se emri i burrit a i të fejuarit nuk zihet në gojë nga gruaja, ishte tabu në atë mjedis tejet fanatik, ndaj dhe në këngë, jo për epitet, por si eufemizëm thirrej dilber, zog skifteri, zogi i qyqes etj. "*Kush ma pa dilberin tem*", "*Ore zog behari, a po t'vret kahari?*". Këngët në të shumtën e rasteve janë një monolog lirik i gruas për t'i thënë diçka burrit, për t'i shprehur boshllëkun që ndjen larg tij, dhembjet e një plage, që s'është e zonja ta shërojë. Po ta kishte pranë ajo do t'i qëndronte afër burrit, do të kryente më së miri detyrat e një bashkëshortje të vërtetë, do ta nxirrte në mejdan të larë e të ndërruar si ato ditë që e kishte pranë, me xhamadanin akull, me tirqit e bardhë e nortat dy e tri. "*Kur dilshe në Bakëll, Xhamadani akëll*" (*Fusha e Korabit*), fillon me një apostrofë të personifikuar që na jep menjëherë motivin, idenë, problemin:

*Moj Fush'e Korabit, e njera unë,
Taj na erdhe hakit, e njera unë,
Taj na dave shtratit, e njera unë,*

Mënyra se si e shpreh gruaja dashurinë është shumë domethënëse. Është diçka që buron nga shpirti, nga morali i pastër, nga sinqeriteti.

Me ato dhanore etike që ka vargu (-t'i, m'i, t'm'u) shprehet intimiteti i të dashuruarve, se ata jetojnë afër e me njeri tjetrin, se "*çorapet me breza t'i kam ba sojeza*", t'i kam bërë unë, e bukur, e mira, syzeza jote, prandaj (*kur mbushem me kujtimet e tua, as kam dëshirë të flas e as të qesh*). Mendoni ç'fuqi ndikuese kanë vargjet e këtyre këngëve që, duke u shoqëruar me melodinë e ëmbël të kavallit e zërin e vajzave, të ngjallin emocione të fuqishme, mall e lot dhe njëherësh krenari për ato vrytë të larta morale të gruas, vajzës, motrës e nënës sonë të përvëlur nga mërgimi. Kjo grua a nënë në Këngët e Korabit tregon se ajo është një heroinë e vërtetë, se është e zonja të ndalë Hënën e t'i thotë asaj dy fjalë, të shoh kur dunen Kapat e Gramës, kur rrëzo-hen yjet e qiellit, kur dymon retë e zeza, kur fryn e bijlet, kur gjëmon Korabi e kur

mbushet Veleshica. Ajo prët, lind e rrit fëmijë, jeton orë e minutë me shqetësimet e të shoqit, merr pjesë totalisht në vuajtjet e tij, udhëton bashkë me të, laget e thahet duke lëshuar ferexhen qull në degën e një lisi, ëndërron, shpreson, qan, por nuk jepet. Ajo është një grua delikate me butësi femërore, dhe e rreshkur në acarim e maleve, që ia numëron të shoqit ditët e kthimit në poll të qilimit, që plagët e zemrës i ka qepur në "*qosh të poshterkës*", që kujton "*kuparanen e shkurtë, që i këputi gjunjët*", zogun e qyqes që endet në vetmi. Për "*trëndafilin e hershëm, lotët i bien si breshër*", këputete s'e zë gjumi. Duke qenë të përafërta me tone, ide e ndërtim artistik shpesh vargjet e njërës zëvendësojnë tjetrën, na duket sikur kemi përsëritje vargësh, të një metri, të një mase, të një stili. Por këngëtarët lirik gjatë improvizimeve, shtojnë gjëra të reja, ndryshojnë, plotësojnë, heqin, krijojnë:

*Ç'po na bije ni lashtë shoq,
Trolli po kalbet,
Lagjet e thahet n'Tironë
Mos ma kije dertin
Taj, moj nonë!*

Këngët e Korabit bëjnë një jetë aktive edhe në ditët tona, këndohen e praktikohen jo për nostalgji, por se disa dukuri të atij realiteti që i lindi janë të pranishme edhe sot. Mërgimi ekonomik, kurbeti vazhdon të jetë po aq i dhimbshëm si dikur, malli dhe brenat shoqërojnë gruan e ditëve tona, ndonëse në një realitet të ri. Notat melankolike të "Këngëve të Korabit" i shkojnë për shtat jetës që po kalon vendi ynë dhe treva që i krijoi. Ato vijmë duke u pasuruar me elementë të rinj, me figura të reja, me krijime të këtij realiteti që përjetojmë:

*Ah kjo bjeshkë e Zojave, mori nanë,
Zanat ku m'i ka?
Kapërcyen detin, nana ime,
Nuk po duken ma!*

Korabi i mban sytë nga deti, Veleshica qan, pranverat shkojnë e vijnë, malli djeg gjirin e nënave, retë e zeza zënë diellin e pranvera mbush bjeshkët me bar e lule, me kinxha të njomë e dele rudë, me qen karabash e fyell dhe një fyell i mekur qan aty, duke ia qetsuar hatixhes së bukur tufën e shqerrave.

Dhe "Këngët e Korabit" ecin, jehojnë, shtegtojnë, qajnë e qeshin, mbushen e zbrazen me tingujt e jetës, rriten e lulëzojnë, por nuk thahen kurrë, gjer sa të shterpojnë gurrat e Korabit.

Mes mrekullive dhe legjendave të Kalasë së Dodës

(Vijon nga faqja 5)

LITA, NJË EMËR QË KA BËRË HISTORI EDHE JASHTË KUFIJVE TË KALASË SË DODËS

Në fshatin Ploshtan i vetmi vend që mblidheshin të rinjtë ishte një minimarket i vogël ku më shumë kishte artikuj ushqimor për nevojat e fshatit. Gjetëm pak të rinj të cilët ishin kthyer nga për pushime në endlindje dhe aty në shesh me djthë të njomë po hidhnin ca gota raki. Mes tyre ishte dhe Muharrem Lita. Rremën (se kështu e thërrasin të gjithë) e kishim parë disa herë në Tiranë se atje ka punuar më së shumti por sot ishte kthyer në vendlindje.

-Mburrem që jam pinjoll i një familje me emër, thotë Rrema. Vetëm nga fisi im janë pushkatuar me gjyq e pa gjyq mbi njëzet e ca veta, të gjithë të pafajshëm, por as diktatura nuk e nënshtroi fisin Lita. Lisi mbetet lis dhe pështyma nuk e hedh për tokë megjithëse diktatura nuk i mori parasysh patriotizmin e Mustafë Litës apo Osman Litës i cili ishte delegat në Kongresin e Lushnjës. Shteti i atëhershëm desh i fshijë nga defterët fisin Lita por nuk ia arriti qëllimit. Dështoi me turp përballë të vërtetës.

PO SHTETI A E DI KU NDODHET KALAJA E DODËS?

Një djalë i ri por siç duket ishte i arsimuar afrohet pranë nesh dhe pas një përshëndetje miqësore na thotë:

-Mora vesh se keni ardhur nga Tirana, dhe do të shkruani për Kalanë e Dodës. Mirë bëni se këtu jo ju që jeni shqiptarë por kanë ardhur dhe të huaj. E shikon unë, kam mbaruar fakultetin me nota shkëlqyeshëm dhe nuk kam gjetur punë në administratë, ndaj mora rrugën e gjatë e të vështirë të mërgimit. Këtu kanë ardhur të gjithë vetëm shteti jo. A po dhe ai vjen në anët tona por ama

vetëm në fushata elektorale. E di si mbushen këto shpatina atëherë. Plot me njerëz dhe fuoristrada. Tani jo. Shteti duket se i ka kthyer shpinën kësaj zone dhe përsëri banorët nuk ankohen. Shteti ka vite që e ka braktisur Kalanë e Dodës por megjithatë këtu punohet, këtu jetesa është në nivele më të larta se në vende që shteti ndjehet se është shtet. Vetëm pak punë, vetëm pak investime, vetëm pak vëmendje më shumë nga shteti dhe Kalaja e Dodës mund të kthehet në një park të madh kombëtar, në një turizëm malor që do ta kishin zili dhe Thethi, Valbona apo vise të tjera shqiptare. Këtu mund të zhvillohen piknik, lojra sportive nëpër livadhet fantastike që ka si dhe gjueti me kafshë të egra.

ITIFAKU PËR PYJET

Nëqoftëse kudo zjarret këto kohët e fundit bënë kërdi mbi pyjet në Kala të Dodës nuk ka ndodhur ky fenomen.

-Jo sivjet por asnjëherë nuk kanë ndodhur fenomene të tilla, pyjet i mbrojnë vetë fshatarët, thotë Kaloshi. Janë lidhur si i thonë fjalës itifake në bazë fshatrash dhe një ndër pikat e shumta që përmbajnë këto ligje (kanune fshati) një pjesë e kanë vetëm për pyjet dhe bjeshkët. -E shikon Korabin, thotë Kaloshi, është çveshur. Ka ndodhur një masakër në Sllatinë, po kështu dhe në Lurë, nuk është ajo Lurë që ka qënë më parë. Këtu është kreyt ndryshe. Pyjet i mbron vetë fshati dhe nuk ka nevojë për specialist të ndërmarjes pyjore. Majat e maleve të gjitha të veshura me drurë halor por dhe ahe i japin këtë peisazh Kalasë së Dodës. Nëqoftëse shteti do të kujtohet ndonjë ditë për këtë mrekulli në zonën verilindore të vendit atëherë turistë të huaj por dhe vendas do të turren drejt kësaj perle shqiptare që deri tani ka mbetur e virgjër.

NESËR... PO KUR DO TË VIJË KJO NESËR?

Nesër, të gjithë shpresojnë se e nesërmja do të vijë për Kalanë e Dodës dhe banorët e saj. Kjo është një perlë e vërtetë që dhe shqiptarët ende nuk e njohin. Njerzit nuk kërkojnë vetëm ujë e detit dhe rërën e nxehtë por klimën, ajrin e pastër, ujë e ftohtë që nuk ndodhet nëpër vise të tjera. E Kalaja e Dodës ua afron të gjitha këto. Ndoshta nga 6000 kilometrat rrugë rurale që do të asfaltohen mund të përfitojë edhe kjo zonë deri tani e braktisur. Dhe shpresojnë ende këto njerëz të urtë e fjalë pak se infrastruktura do të rregullohet. Shpresojnë se po u ndërtoja ndonjëherë Skavica kjo ngelet rrugë kryesore që bashkon Dibërën e Kukësin e nesër kur të bëhet rruga e Arbërit edhe fshatrat më të thella të Kukësit këtej do të vërshojnë. Të gjithë shpresojnë se e nesërmja do të vijë një ditë E largët duket kjo kohë por shpresojnë ama se një ditë do të vijë. Në mbrëmje vonë lamë pas Kalanë e Dodës këtë mrekulli shqiptare që jo të gjithë kanë patur fatin ta shikojnë. Edhe ne bashkohemi me shpresën e vetë banorëve se një ditë shteti do të kujtohet se rrëzë këtyre maleve ka banorë, ka banorë që nuk kërkojnë nga shteti, që vetëpunsohen vetë, që bëjnë një jetesë që familje të ndryshme do ta kishin zili edhe në metropolin shqiptar. Dhe këto janë banorët e Kalasë së Dodës, një zonë që ka bërë emër herët në historinë shqiptare Largohe mi me shpresën e mirë se e nesërmja e kësaj zone do të jetë më e mirë, se turistët do të vërshojnë edhe në Kala të Dodës. Edhe ne u larguam me shpresën se një ditë do të kthehem dhe do të shikojmë një realitet kreyt ndryshe.

Sh.Skarra

Kosovaret e dhunuara - argumenti më bindës për pavarësinë e Kosovës

Libër që duhet përkthyer dhe shpërndarë në tërë botën

Nga
Rexhep Torte



Epërditshmja e pavarur "Fakti" në hapërimin e saj drejt dhjetëvjetorit të daljes, në vazhdimësi po dëshmohet si medium serioz duke përfshirë tërë spektrin jetësor dhe çështjen shqiptare.

Kjo është rruga më e mirë për të qenë gjithnjë pranë dhe me lexuesin.

Fillimi i botimit ditë më parë i fejtimit me mbititull "Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë" i autores Luljeta Selimi, është edhe një dëshmi e sensit të qëlluar redaktorial dhe kombëtar të kësaj gazete.

Meritë për këtë ka edhe autorja gazetare Luljeta Selimi, e cila ka ditur të zgjedhë për ta punuar dhe për ta publikuar një temë kaq tronditëse, të vështirë, por të qëlluar, të nevojshme, të domosdoshme për shqiptarët dhe më godatëse ndaj të gjithë atyre që zvarrisin dhe pengojnë pavarësinë e merituar të Kosovës.

Meritë për këtë ka edhe redaksia e "Faktit", e cila si edhe gjatë luftës së UÇK në Kosovë, kur pjesa dërmuese e gazetarëve të atjeshëm profesionistë shqiptarë kapi ekzodin, "Fakti" diji të gjejë korrespondentë nga terreni, si edhe gjatë luftës së UÇK në Maqedoni, kur plot guxim dhe profesionalizëm të pashoq diti të prezentojë realisht me tekst dhe fotografi, ndodhitë e sidomos sulmet, dhunën dhe torturat policisë e ushtrisë maqedonase ndaj popullatës së pafajshme shqiptare.

Fejtoni i gazetares kosovare Luljeta Selimi që po botohet në "Fakti" ka zgjuar interesim të jashtëzakonshëm të lexuesit e kësaj gazete.

Luljeta Selimi me këtë libër ka bërë gjënë më sublime për Kosovën dhe për mbarë popullin shqiptar, që gjendet në ankthin e pritjes së pavarësisë së Kosovës.

Luljeta Selimi me një përgjegjësi dhe angazhim hulumtues lakmues, që do t'ia kishte zili edhe gazetari më profesionist i kalibrin me përmasa botërore, po i dhuron lexuesit një të vërtetë të tmerrshme, po i dhuron lexuesit dhe mbarë opinionit të mësojë e të dijë më shumë për gjenin shtazarak serb ndaj shqiptarëve të Kosovës, e sidomos ndaj grave dhe femrave të pafajshme

Ky libër i përkthyer dhe i botuar në gjuhët e huaja, sa më shpejt duhet tu dërgohet të gjithë ambasadorëve dhe përfaqësuesve në Kombet e Bashkuara, Unionin Evropian, Këshillin e Evropës, Grupin e Kontaktit dhe të gjithë burshtetasve evropianë e botërorë, për të lexuar dhe për të kuptuar një herë e përgjithmonë, se çfarë krimesh makabre kanë bërë serbët ndaj kosovarëve të pafajshëm dhe sidomos ndaj vajzave dhe grave shqiptare kosovare.

kosovare gjatë periudhës së gjenocidit serb në Kosovë.

Rrëfimet e argumentuara me shembuj konkretë të dhunimit të grave dhe vajzave shqiptare kosovare nga ana e serbëve në këtë fejtון, janë nga më tronditëset dhe më trishtueset që mund t'i imagjinojë mendja e njeriut dhe që mund t'i kryejë njeriu.

Ky fejtון është argumenti më i fuqishëm që Kosova sa më shpejt ta fitojë pavarësinë.

Ky fejtון duhet përkthyer dhe botuar në gjuhët botërore dhe për këtë duhet angazhuar pa u vonuar biznesmenët shqiptarë në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe në diasporë.

Ky fejtון i përkthyer dhe i botuar në gjuhët e huaja, sa më shpejt duhet t'u dërgohet të gjithë ambasadorëve dhe përfaqësuesve në Kombet e Bashkuara, Unionin Evropian, Këshillin e Evropës, Grupin e Kontaktit dhe të gjithë burshtetasve evropianë e botërorë, për të lexuar dhe për të kuptuar një herë e përgjithmonë, se çfarë krimesh makabre kanë bërë serbët ndaj kosovarëve të pafajshëm dhe sidomos ndaj vajzave dhe grave shqiptare kosovare.

Përkthimi, botimi dhe leximi i këtij libri, do të jetë argumenti më bindës në ngritjen e vetëdijes evropiane e mbarëbotërore, se pavarësia e Kosovës është e domosdoshme dhe gjëja më e vogël që duhet tu jepet kosovarëve pas atyre vrasjeve, vuajtjeve dhe dhunimeve që ua kalojnë edhe atyre të ferrit.




Lulzim Aziri është një djalë i ri nga Dibra që nuk merret me politikë, xhola, thashetheme, korrupsion... por merret me vizatime!. Në këto ditë moderne ky profesion është më i gabuari, pasi krejt njerëzit kanë kokën tek \$\$\$\$. Arti tek të rinjtë dibranë është në një mëshirë, ose me mirë thuj, "nuk egziston", pra për këtë arsye shpreha vullnetin të bëj disa fotografi sa për të përshëndetur Lulin për pasionin që ka. Shpresoj që rinia dibrane të ringjallë talentin si në muzikë, sporte, libra, pikturë, etj. (Gazmend Kërkuti. www.dibra.org)

BOTIMETË REJATË AUTORËVE DIBRANË

FOTO FAKT



Gjuetia me dinamit, një modë e zakonshme e kapjes së peshkut në Drin...



Promovimi i Librit "Një Kosovë e vogël në Dibër të Madhe" nga Prof. Mahmud Hysa.
Foto: G. Kërkuti